



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:
“Shkenca Kompjuterike”
Universiteti “Polis”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Elva Leka

Dr. Senada Bushati

Qershor / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave/Arteve në “Shkenca Kompjuterike”**

1	IAL aplikues:	Universiteti Polis
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Kërkimit Shkencor
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 352, date 17.09.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.a. 2022 – 2023 – 8 PAE / 5 PAK v.a. 2023-2024 – 8 PAE / 6 PAK
18	Numri i studentëve:	V.a. 2022 – 2023 – 18 studentë V.a. 2023-2024 – 36 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM


Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” ofrohet nga Departamenti i Kërkimit Shkencor, Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim (FKZH), Universiteti POLIS.

Hapja e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” është miratuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr. 352, datë 17.09.2021, pasi ka kaluar të gjitha fazat e propozimeve dhe miratimit brenda Institucionit.

Programi i studimit është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nevojat e tregut rajonal për specialistë në fushën e Shkencave Kompjuterike.

Ky program realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i Shkencave” në “Shkenca Kompjuterike” në Fakultetin për Kërkim dhe Zhvillim (FKZH), të Universitetit POLIS, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” është ofruar për herë të parë në vitin akademik 2022 – 2023. Në vitin akademik 2022 – 2023, janë regjistruar 19 studentë, në vitin akademik 2023 – 2024 17 studentë.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Grupi i Eksperteve të Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga dy anëtarë: Dr. Elva LEKA dhe Dr. Senada BUSHATI, me mbështetjen e koordinatorës teknike të ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Procesi i vlerësimit të jashtëm ka filluar në muajin maj 2023 me kërkesën nga ana e Universitetit POLIS, duke vijuar me dorëzimin e dokumentacionit në dhjetor 2023. Ekspertët u njohën me DVV nëpërmjet sistemit të menaxhimit elektronik AMS të ASCAL.

Mbi bazën e një axhende të përcaktuar nga ASCAL në bashkëpunim me Universitetin Polis, në datat 17 dhe 18 Janar 2024, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vizitoi institucionin dhe realizoi një sërë takimesh e intervistash me Dekanin e Fakultetit për Kërkim dhe Zhvillim (FKZH), Përgjegjësin e Departamentit të Kërkimit Shkencor, me Grupin e vetëvlerësimit të programit, me Koordinatorën e programit të studimit, me stafin akademik të programit të studimit, me përfaqësues të Sektorit të Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit, me përfaqësues të Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, me studentët e programit të studimit dhe me përfaqësues të Sektorit të Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve. Gjithashtu GVJ, zhvilloi vizita në Sekretarinë Mësimore, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Bibliotekë si dhe u njoh me mjediset e zhvillimit të procesit mësimor. Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, si dhe të informacionit të mbledhur gjatë vizitës në Institucion.

Universiteti Polis është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 14.05.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 26/4 Prot, datë 14.05.2024. Universiteti Polis përcjell në ASCAL më datë 24.05.2024, me anë të shkresës me Nr. 448/24 Prot, datë 21.05.2024, "Komente mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm për programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në: "Shkenca Kompjuterike".

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

1. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi II.3, Kriteri 4**, GVJ merr në konsideratë sqarimin e bërë nga Institucioni në lidhje me temat javore, ku cdo javë referuar temës së përcaktuar në planin mësimor zhvillohet leksioni seminari dhe ushtrimet laboratorike. Të gjitha komponentët e planit mësimor zhvillohen në mjediset laboratorike të universitetit. **Raporti në këtë pikë ndryshon si më poshtë:**
GVJ sugjeron që (1) në syllabus-et e lëndëve të paraqiten temat javore me orët përkatëse në secilën javë sipas ndarjes në leksione, seminare, labore dhe detyra kursi; (2) Evidentimin në kurrikul dhe në syllabuset e lëndëve të krediteve të dedikuar detyrave të kursit/projekteve (1 ECTS = 1 -2 orë në auditor)
2. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi III.3, Kriteri 1**, GVJ vlerëson faktin që Universiteti POLIS ka marrëveshje dhe bashkëpunime me institucione e kompani partnere, në të

cilat kryhen edhe praktikat e studentëve, në mënyrë që studentët të marrin përfitimet më të mira praktike e profesionale. GVJ vlerëson gjithashtu procedurën e ndjekjes së praktikës profesionale duke plotësuar 'Formularin e Angazhimit' dhe 'Formularin e Vlerësimit në Intership', megjithatë komenti në këtë pike i referohet sugjerimit për përgatitjen e një "Udhëzuesi të përgatitjes së relacionit të praktikës profesionale". **Raporti në këtë pikë ndryshon si më poshtë:**

Megjithatë nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ vëren se nuk ka një udhëzim për përgatitjen e relacionit praktikës profesionale, ndaj GVJ sugjeron që institucioni të hartojë një "Udhëzues të përgatitjes së relacionit të praktikës profesionale".

3. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi III.3, Kriteri 2**, GVJ vlerëson angazhimin e asistentëve në kryerjen e procesit të provimit. Nisur nga kërkesat e kriterit III.3, sugjerohet të hartohet një procedurë për anonimitetin e kryerjes së provimeve, me anë të sekretimit të provimeve apo të vendosjes se 'barcod'-eve për të siguruar anonimitetin e studentit gjatë korrigjimit të tezës. **Raporti në këtë pike ndryshon pjesërisht si më poshtë:**

GVJ vëren se programi Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" nuk ka paraqitur një procedurë për anonimitetin e kryerjes së provimeve, ndaj GVJ sugjeron që institucioni të hartojë një procedurë për anonimitetin e kryerjes së provimeve, me anë të sekretimit të provimeve apo të vendosjes se 'barcod'-eve për të siguruar anonimitetin e studentit gjatë korrigjimit të tezës.

4. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi III.3, Kriteri 5**, GVJ merr në konsideratë që udhëzimet për zhvillimet e provimeve janë të përcaktuara në Rregulloren e Përgjithsme dhe atë didaktike duke lënë aktiv vetëm sugjerimin e mësipërm të Standardit III.3, Kriteri 2. **Raporti në këtë pikë ndryshon (Hiqet rekomandimi i dhënë).**

5. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi III.4, Kriteri 4**, GVJ vlerëson angazhimin e institucionit në bërjen publike të thirrjeve për mobilitete të studentëve. Nga vizita në institucion dhe takimi me studentët konstatoi që arsyeja kryesore e mospjesëmarrjes së tyre në mobilitete ishte angazhimi i tyre në punë. Megjithatë, GVJ sugjerohet që të hartohet një strategji nga institucioni për nxitjen e studentëve në mobilitete. Pranohen komentet e institucionit lidhur me infrastrukturën IT dhe bibliotekën, por rekomandohet që literatura e 5-viteve të fundit të përditësohet edhe në syllabus-et e lëndëve. **Raporti në këtë pikë ndryshon pjesërisht si më poshtë:**

GVJ, nga evidencat e vëna në dispozicion dhe takimi në institucion, konstaton se:

- Deri më tani në rang ndërkombëtar bëhet fjalë vetëm për mobilitetin e stafit akademik, ndërsa nuk ka pasur mobilitete të studentëve të këtij programi studimi.

GVJ vlerëson kontoributin që institucioni jep në kuadër të praktikave profesionale, mbështetjes për studime kërkimore shkencore në thellimin e njohurive, por rekomandon që:

- Institucioni të hartojë një strategji për nxitjen e pjesëmarrjes së studentëve në mobilitete.

6. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi IV.1, Kriteri 1**, sa i përket këtij kriteri, citohet që stafi i angazhuar duhet të jetë minimalisht me gradën Dr. Duke ju referuar tabelave të dhëna, stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie me gradën MSc, është deklaruar si staf akademik PAE ose PAK, dhe jo staf ndihmës akademik 'Laborant'. Pranohet fakti që titullaret e kurseve, referuar syllabuseve, janë staf me tituj dhe grada. Ky fakt duhet pasqyruar edhe në tabelën e planit mësimor. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

7. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi IV.1, Kriteri 2**, GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit në tekst në lidhje me përballimin e ngarkesës mësimore të programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike", nga staf akademik efektiv. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

8. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi IV.1, Kriteri 8**, GVJ rekomandon që të ketë një udhëzim për mënyrën e raportimit të Praktikës Profesionale. **Raporti në këtë pikë ndryshon pjesërisht si më poshtë:**

GVJ sugjeron që Institucioni të hartojë një "*Udhëzim të përgatitjes së relacionit të praktikës profesionale*", në mënyrë që studentët ta kenë të qartë mënyrën e organizimit dhe zhvillimit të këtij kursi.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Në përputhje me Statutin e tij [Evidencë 4, Neni 3, fq. 4], Strategjinë Kombëtare për Arsim [Evidencë 5, fq. 3], Universiteti POLIS ka mision të përgatisë profesionistë dhe qytetarë aktivë për shoqërinë demokratike shqiptare dhe për vlerat europiane. Universiteti POLIS realizon misionin e tij përmes zhvillimit të arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë, në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor, për rritjen e mirëqenies dhe dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente. Aneks 1 Statuti i Universitetit POLIS.pdf Aneks 2 Strategjia e Zhvillimit 2021-2026.pdf
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i Studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” është mbështetur dhe hartuar në përputhje me misionin e Universitetit POLIS për të formuar specialistë të lartë dhe përgatitur shkencëtarë të rinj [Evidencë 4, Neni 3, fq. 4] dhe me Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit POLIS [Evidencë 5, Neni 3], përmes të cilës, në kuadër të interesit rajonal, Universiteti POLIS, synon, ndër të tjera, përgatitjen e individëve të mirëkualifikuar, produktivë, të orientuar drejt kërkimit shkencor dhe të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare. Aneks 1 Statuti i Universitetit POLIS.pdf Aneks 2 Strategjia e Zhvillimit 2021-2026.pdf
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në	Programi i Studimeve <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” është mbështetur dhe hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të brendshëm të institucionit [Evidencë 5,

<p>zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>fq. 3] dhe në përputhje me strategjinë e programit [Evidencë 15, fq. 1-3], duke qenë një vazhdim i suksesshëm i programeve <i>Bachelor</i> në Shkenca Kompjuterike.</p> <p>Ky program studimi është zhvilluar në bazë të nevojave të tregut të punës [Evidencë 14] dhe në përputhje të plotë me Vendimin e Këshillit të Ministravë nr.41, date 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar.</p> <p><u>Evidencë 9, neni 1-2, fq. 2</u></p> <p><u>Aneks 2 Strategjia e Zhvillimit 2021-2026.pdf</u></p> <p><u>Aneks 12 Strategjia e Zhvillimit Msc. Shkenca Kompjuterike al en.pdf</u></p> <p><u>Aneks 11 Misioni dhe studimi i tregut Msc.Shkenca Kompjuterike.pdf</u></p> <p><u>Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf</u></p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi <i>Master i Shkencave</i> në Shkenca Kompjuterike kontribon në përmbushjen e objektivave dhe interesave kombëtarë në përputhje me prioritetet SKZHIE 2030, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacioniet (SKSTI 2020), me Strategjinë e Inovacionit dhe Teknologjisë me Biznesin (BITS), me Strategjinë për TIK (miratuar me Vendim KM Nr. 2016, datë 10.04. 2003.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” ofrohet nga Departamenti i Kërkimit Shkencor, si pjesë e Fakultetit për Kërkim dhe Zhvillim (FKKZH) në përputhje me interesat kombëtare, me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me fushën e veprimtarisë së tij akademike dhe profesionale.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi I.2




Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” ka përvojën dhe kualifikimin e duhur për ofrimin e tij [Evidencë 90-106].</p> <p>Gjatë vitit akademik 2023 – 2024, Departamenti i Kërkimit Shkencor, si pjesë e Fakultetit për Kërkim dhe Zhvillim ka në përbërje të tij [Evidencë 107] 18 personel akademik efektiv (PAE) nga ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 Prof. Dr; - 1 Prof. Asoc; - 6 Dr; - 3 Dr. Proc; - 6 MSc; <p>24 personel akademik me kontratë (PAK) nga ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 Prof. Dr; - 2 Prof. Asoc. Dr; - 7 Dr; - 2 Dr. Proc.; - 11 MSc; <p><i>Departamenti i Kërkimit Shkencor</i> disponon, në funksion të programeve të studimit që ofron, laboratorë bashkëkohorë përmes të cilëve, studentët realizojnë orët praktike në përputhje me programin e studimit dhe nevojat për aftësimin praktik të tyre.</p> <p><u>Aneks 30 Tabelat permbledhese per Aneks RVB SHK 01.pdf</u></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe</p>	<p>Programi i studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” ofrohet nga Departamenti i Kërkimit Shkencor si pjesë e Fakultetit për Kërkim dhe Zhvillim, në përputhje me fushën e përgjithshme dhe specifike të tij. Fusha e studimit të programit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” është në përputhje akademike dhe kërkimore me programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Shkenca Kompjuterike” të ofruar në departament.</p> <p>Kodifikimi i lëndëve, në zbatim të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022, është në proces [Evidencë 77].</p>

udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Aneks 50 Kodifikimi i programeve ne POLIS.pdf
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	<p>Programi i studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” ofruar nga Departamenti i Kërkimit Shkencor (DKSH), si pjesë e Fakultetit për Kërkim dhe Zhvillim (FKZH) [Evidencë 15, fq. 1-3] është një program, i cili i shtohet ofertës akademike pranë këtij fakulteti.</p> <p>Programi është në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit Polis duke ofruar një qasje ndërdisiplinore të shkencave kompjuterike.</p> <p>Aneks 12 Strategjia e Zhvillimit Msc. Shkenca Kompjuterike al en.pdf</p>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.	Nuk aplikohet
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	<p>Programi <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” nuk e ka akoma brezin e parë të studentëve të diplomuar. Megjithatë, Universiteti POLIS, bazuar në strategjinë e tij, është i angazhuar të ofrojë trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar, duke i përditësuar studentët me njoftime të ndryshme nga tregu i punës dhe praktikave profesionale. Universiteti Polis ka marrëveshje bashkëpunimi me kompani të ndryshme në fushën e Teknologjisë së Informacoinit si Lufthansa, Team System, iKUB etj. [Evidencë 86]</p> <p>Aneks 54_ Marreveshjet aktive për programin e studimit.pdf</p>
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni disponon infrastrukturën laboratorike dhe burimet njerëzore të nevojshme për realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike”.</i>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Organizimi i programit të studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” realizohet nga Departamenti i Kërkimit Shkencor, Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim, mbështetur në rregulloren e Universitetit POLIS [Evidencë 6] si dhe të gjithë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Angazhimi i personelit akademik me kohë të plotë, personelit akademik nga fakultete të tjera të Universitetit POLIS, si dhe angazhimi i personelit akademik me kontratë bazohet në marrjen e përgjegjësisë respektive dhe vlerësimin e vazhdueshëm të punës së tyre [Evidencë 19] [Evidencë 21] [Evidencë 22] [Evidencë 23] [Evidencë 78].</p> <p>Marrëdhënia midis strukturave të ndryshme brenda U_POLIS, njësive të ndryshme administrative dhe akademike rregullohet përmes rregullores së brendshme të Institucionit [Evidencë 8].</p> <p>Analizat e vazhdueshme të punës së stafit akademik dhe administrativ e realizuar nga Institucioni, tregojnë rezultate shumë të kënaqshme referuar rezultateve të mbledhura nga analiza e formularëve të vlerësimit të lëndëve, analiza e strukturës së cilësisë së provimit si edhe procesin e vlerësimit të kurrikulës apo përgatitjen e raporteve të vetëvlerësimit të programeve [Evidencë 73].</p> <p>Aneks 3 Rregullore Pergjithshme.pdf</p> <p>Aneks 14 Guida e stafit_en.pdf</p> <p>Aneks 17.1 Vleresimi i kolegut per kolegun.pdf</p>

	<p>Aneks 17.1_Vleresimi i kolegut per kolegun.pdf</p> <p>Aneks 17.4_Pyetesor per vleresimin e pedagogut nga studentet.pdf</p> <p>Aneks 47_Formular vleresimi gjate procesit te rekrutimit.pdf</p> <p>Aneks 5_Rregullore_FKZH.pdf</p> <p>Aneks 49_Raporti i vleresimit te departamentit per stafin akademik.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të programit të studimit, Universiteti POLIS ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh homologe vendase dhe të huaja si: Universiteti i Tiranës, Universiteti “Eqerm Cabej”, Universiteti “Fan S. Noli”, Akademia e Shkencave, University of Thessaloniki ne Greqi, National Kapodistrian University of Athens, Universidad de Cordoba, Linnaeus University etj. [Evidencë 76, Evidencë 58, Tabela nr.5, Evidencë 86], të cilat mundësojnë shkëmbimin e stafit dhe studentëve, aplikimin në projekte të përbashkëta dhe implementimin me sukses të projekteve të fituara [Evidencë 65, Evidencë 66, Evidencë 68].</p> <p>Aneks 42_Institucionet dhe organizatat ne bashkepunim ne nivel institucional.pdf</p> <p>Aneks 30_Tabela ASCAL Msc CS.pdf</p> <p>Aneks 54_Marreveshjet aktive për programin e studimit.pdf</p> <p>Aneks 37_Lista e projekteve nderkombetare-22-23.pdf</p> <p>Aneks 38_Lista e stafit te angazhuar ne projekte.pdf</p> <p>Aneks 39_Lista e studenteve te angazhuar ne projekt.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon</p>	<p>Në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale, Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me ente, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre në drejtim të shkencave kompjuterike dhe teknologjisë së informacionit, si: TeamSystem, Albtelecom Sha, Abisnet, Balfin, Crystal Systems, Green Leaf, Infosoft [Evidencë 86] etj. Departamenti i Kërkimit Shkencor, Zyra e Mbështetjes së studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK), ofrojnë politika bashkëpunimi dhe marrëveshje partneriteti në funksion të Programit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” [Evidencë 34].</p>

<p>me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Aneks 54_Marreveshjet aktive për programin e studimit.pdf</p> <p>Aneks 25_Politika Mbeshtetese dhe Marreveshje bashkepunimi i Msc.pdf</p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Kërkimit Shkencor kujdeset për krijimin e mundësive për zhvillimin korrekt të praktikave profesionale për të gjithë studentët e tij, në përputhje me programin e studimit të ofruar [Evidencë 81].</p> <p>Për të analizuar arritjet dhe për të përcaktuar objektivat, kryhen raporte vjetore të realizuara nga Departamenti [Evidencë 73] [Evidencë 29] dhe Raporte Vjetore Institucionale [Evidencë 75], të realizuar nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) [Evidencë 62], <u>por jo raport analitik të mirëfilltë të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.</u></p> <p>Aneks 43_Formulari për kryerjen e praktikës-intershipit.pdf</p> <p>Aneks 49_Raporti i vleresimit te departamentit per stafin akademik.pdf</p> <p>Aneks 22_Raport Vjetor kerkimi shkencor 22-23.pdf</p> <p>Aneks 48_Raporti Vjetor 2022-2023.pdf</p> <p>Aneks 32_Raporti Vjetor NJBSC 2022-2023.pdf</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të ndryshme të Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, të cilat mundësojnë shkëmbimin e stafit dhe studentëve, aplikimin në projekte të përbashkëta dhe implementimin me sukses të projekteve të fituara.</i></p> <p><i>Universiteti POLIS falë bashkëpunimeve me ente vendase mundëson zhvillimin korrekt të praktikave profesionale të studentëve, në përputhje me profilin e studimeve të tyre.</i></p> <p><i>GVJ, nisur nga DVV dhe nga vizita në Institucion, konstaton që Institucioni nuk ka hartuar një raport analitik të mirëfilltë të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit duke specifikuar qartazi përfitimet për secilin program studimi të ofruar.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>




				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1																
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.																
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve															
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit <i>Master Shkencor</i> në “Shkenca Kompjuterike”, i ofruar nga Departamenti i Kërkimit Shkencor pranë Universitetit POLIS, është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) [Evidencë 58, Tabela 9].</p> <p>Çdo lëndë i është caktuar numri i duhur i krediteve ECTS në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar. Mbështetur në VKM-në e mësipërme, janë ndërtuar në përputhje të plotë edhe kurrikula dhe planprogramet e lëndëve.</p>															
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Tipi veprimtarise</th> <th>Tipi i Aktivitetit</th> <th>Nr. i ECTS</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>Aktivite në disiplina të formimit të përgjithshëm</td> <td>12 ECTS</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>Aktivite në disiplinat e formimit të karakterizuar</td> <td>63 ECTS</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>Aktivite në disiplina ndërdisiplinore dhe intriguase</td> <td>15 ECTS</td> </tr> <tr> <td>D</td> <td>Aktivite në disiplina plotësuese</td> <td>12 ECTS</td> </tr> </tbody> </table>	Tipi veprimtarise	Tipi i Aktivitetit	Nr. i ECTS	A	Aktivite në disiplina të formimit të përgjithshëm	12 ECTS	B	Aktivite në disiplinat e formimit të karakterizuar	63 ECTS	C	Aktivite në disiplina ndërdisiplinore dhe intriguase	15 ECTS	D	Aktivite në disiplina plotësuese	12 ECTS
	Tipi veprimtarise	Tipi i Aktivitetit	Nr. i ECTS													
	A	Aktivite në disiplina të formimit të përgjithshëm	12 ECTS													
	B	Aktivite në disiplinat e formimit të karakterizuar	63 ECTS													
C	Aktivite në disiplina ndërdisiplinore dhe intriguase	15 ECTS														
D	Aktivite në disiplina plotësuese	12 ECTS														

	E	Përgatitja e tezës së diplomës	18 ECTS
	Totali		120 ECTS
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Nga shpërndarja e krediteve sipas tabelës së mësipërme programi i studimit ka në planin e tij:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëndë bazë (A) – 12 ECTS – 10 %; - Lëndë karakterizuese (B) – 63 ECTS – 52.5 %; - Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) – 15 ECTS – 12.5 %; - Lëndë plotësuese (D) – 12 ECTS – 10 %; - Detyrime përmbyllëse (E) – 18 ECTS – 15 %; <p>GVJ konstaton që sipas VKM Nr. 41:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëndët ndërdisiplinore/integrese (A) duhet të jenë në masën 15-20%; - Lëndët plotësuese (E) duhet të jenë në masën 3-5%; <p>GVJ rekomandon rishikimin dhe shpërndarjen e krediteve në përputhshmëri me VKM Nr. 41.</p> <p><u>Aneks 30_Tabela ASCAL Msc CS.pdf</u></p> <p>Programi i studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” është zhvilluar në përputhje me Nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), të dispozitave të ligjit numër 10 247, datë 04.03.2010. Orientimi i programit të studimit <i>Shkenca Kompjuterike</i> i specifikuar edhe në Statutin e Universitetit [Evidencë 4], demonstroi aftësi kërkimore të cilat janë të disponueshme në Departamentin e Kërkimit Shkencor.</p> <p>Objektivat kryesore formuese të këtij programi, mbështetur në Nivelin 7 në KSHK, në lidhje me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që një student i diplomuar në Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike duhet të plotësojë janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Përgatitja e specialistëve me kualifikim bashkëkohor me njohuri të avancuara në fushën e shkencave kompjuterike dhe teknologjisë së informacionit, duke përfshirë analizën kritike të teorive, parimeve, vlerësimeve të njohurive, mjeteve dhe pajisjeve si edhe kritereve të performancës; b. Përgatitja e specialistëve me kualifikim bashkëkohor për aftësi të avancuara në shkenca kompjuterike, si “machine 		

	<p>learning”, inteligjenca artificiale, “cyber security” duke demonstruar inovacion, zgjidhje të problemeve komplekse, përmirësimin e sigurimit të cilësisë;</p> <p>c. Përgatitja e specialistëve të kualifikuar për menaxhimin e aktiviteteve apo projekteve komplekse teknike ose profesionale, duke i përgatitur për përgjegjësi vendimmarrje. Aneks 1 Statuti i Universitetit POLIS.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Lëndët/modulet janë grupuar sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 me ngarkesën përkatëse në kredite, si më poshtë [Evidencë 58, Tabela 9]:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëndë bazë (A) – 12 ECTS; - Lëndë karakterizuese (B) – 63 ECTS; - Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) – 15 ECTS; - Lëndë plotësuese (D) – 12 ECTS; - Detyrime përmbyllëse (E) – 18 ECTS; <p>GVJ konstaton që sipas VKM Nr. 41:</p> <p>Programi i studimit i ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe detyrimeve përmbyllëse. Aneks 30 Tabela ASCAL Msc CS.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Nuk aplikohet</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të</p>	<p>Nuk aplikohet</p>

<p>krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Nuk aplikohet</p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Universiteti POLIS nuk ofron program tjetër studimi në të njëjtën fushë studimi, cikël dhe me të njëjtën emërtësë.</p> <p>Universiteti është në proces të kodifikimit të programeve të studimit që ofrohen në të tre ciklet e studimit në përputhje me fushën specifike të studimit.</p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Kodifikimi i lëndëve, në zbatim të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022, është në proces. Universiteti POLIS ka depozituar dokumentacionin përkatës për propozimin e kodifikimit të programeve për të gjitha programet të cilat ofrohen aktualisht nga institucioni [Evidencë 77]:</p> <p>Aneks 50_Kodifikimi i programeve ne POLIS.pdf</p>

<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, duke qenë një program i ri studimi.</p> <p>Institucioni në praktikat e tij ka programe të përbashkëta studimi të nivelit të tretë, të cilat ofrohen si “<i>Double Degree</i>” në bashkëpunim me Universitetin e Ferrara-s, Itali.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” ofron njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për formimin e specialistëve në fushën e shkencave kompjuterike. Ai është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</i></p> <p><i>Universiteti POLIS ndjek politikat dhe procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes së studenteve bazuar në kriteret dhe afatet ligjore të përcaktuara në aktet ligjore përkatëse dhe në përputhje me kapacitetet e tij në infrastrukturë, burime njerëzore dhe kërkesat e tregut.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.2</p>	
<p>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim si njësi kryesore është i përbërë nga këto njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Kërkimit Shkencor; 2. Departamenti i Kërkimit të Aplikuar; 3. Qendra e Burimeve dhe Informacionit; <p>Institucioni, bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ka miratuar:</p>

1. Statutin e Universitetit POLIS, urdhër MASR Nr. 281, datë 19/05/2017 [Evidencë 4],
2. Rregulloren e Universitetit [Evidencë 6],
3. Rregulloren e Njesisë Kryesore – FKZH [Evidencë 8],
4. Rregullore e Programit të Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike [Evidencë 9].

Mbi bazën e tyre është ngritur Struktura Akadematike e FKZH si më poshtë:

Strukturat drejtuese:

- Dekan (Drejtues i Njesisë Kryesore),
- 3 Zëvendës dekanë,
- 3 Përgjegjës Departamenti (drejtues të Njësive Bazë),

Strukturat mbështetëse:

- 1 kryesekretare,
- 3 sekretare mësimore,
- 4 laborantë.

Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim në vitin akademik 2023-2024 është i përberë nga Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti (32 pedagogë PAE) dhe 31 Personel Akademik me Kontratë, të cilët kanë kualifikimin si më poshtë: [Evidencë 58]

Kualifikimi i stafit	Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim	
	PAE	PAK
Prof.Dr	2	2
Prof.Asoc	1	2
Dr/PhD	12	9
Msc	17	18
Gjithsej	32	31
	63	

Njësia bazë, Departamenti i Kërkimit Shkencor përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike”, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë [Evidencë 18]:

Tituj/ grada	2022 – 2023		2023 – 2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	2	1	2	2
Prof. Asoc.	1	2	1	2
Dr./PhD.	5	7	6	7
Msc.	9	9	9	13
Totali	17	19	18	24

GVJ konstaton nga [Evidencë 58, tabela 12.1, tabela 12.2, faqe 13], se shperndarja e ngarkesës së stafit akademik është:

- *Në vitin akademik 2023-2024* – ngarkesa e stafit akademik efektiv **PAE** është 608 orë nga 947 orë = **64.2%** dhe ngarkesa e stafit me kontrate **PAK**, 339 orë nga 947 = **35.8%**;
- *Për vitin akademik 2022-2023* - ngarkesa e stafit akademik efektiv **PAE** 436 orë nga 585 orë = **74.5%** dhe ngarkesa e stafit me kontrate **PAK**, 149 orë nga 585 = **25.5 %**.

Nga sa më sipër Departamenti i Kërkimit Shkencor plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë.

[Aneks 1 Statuti i Universitetit POLIS.pdf](#)

[Aneks 3 Rregullore Pergjithshme.pdf](#)

[Aneks 5 Rregullore FKZH.pdf](#)

[Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf](#)

[Aneks 30 Tabela ASCAL Msc CS.pdf](#)

[Aneks 15 Organigrama-Struktura Organizative POLIS.pdf](#)

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në

Departamenti i Kërkimit Shkencor angazhon në kuadër të praktikave profesionale dhe laboreve staf akademik dhe ndihmës akademik me kualifikimet përkatëse për realizimin korrekt të tyre [Evidencë 4, Evidencë 9], duke përdorur udhëzimet e parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë

legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. Aneks 1 Statuti i Universitetit POLIS.pdf Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Departamenti i Kërkimit Shkencor, si pjesë e Fakultetit të Kërkimit dhe Zhvillimit, cakton një koordinator për çdo program studimi. Koordinator për programin e studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” është Dhurata Shehu. Koordinator i programit zhvillon veprimtaritë e tij në përputhje me rregulloren e programit të studimit [Evidencë 9], dhe raporton periodikisht tek shefi i departamentit dhe dekani. Në cilësinë e koordinatorit, zhvillon vazhdimisht takime me studentët dhe stafin e përfshirë në programin e studimit. Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën	Programi i studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” është hartuar dhe ofrohet nga Departamenti i Kërkimit Shkencor, pranë Fakultetit për Kërkim dhe Zhvillim. Departamenti i Kërkimit Shkencor disponon të gjitha informacionet e nevojshme për mbarëvajtjen e këtij programi studimi, në përputhje me Statutin [Evidencë 4] dhe rregulloren e Universitetit [Evidencë 6], rregulloren Didaktike [Evidencë 7].

<p>dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Informacioni i nevojshëm për organizimin dhe kurrikulën e programit paraqitet në Planin Strategjik të Departamentit [Evidencë 15] dhe publikohet gjithashtu në faqen zyrtare web të universitetit POLIS.</p> <p>https://universitetipolis.edu.al/master-i-shkencave-ne-shkenca-kompjuterike/.</p> <p>Aneks 1 Statuti i Universitetit POLIS.pdf</p> <p>Aneks 3 Rregullore Pergjithshme.pdf</p> <p>Aneks 4 Rregullore Didaktike.pdf</p> <p>Aneks 12 Strategjia e Zhvillimit Msc. Shkenca Kompjuterike_al_en.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Në planin mësimor [Evidencë 72] të programit të studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike”, si dhe në syllabuset e lëndëve [Evidencë 42-57] jepet ngarkesa e studentëve në auditor dhe jashtë tij për çdo aktivitet formues. Frekuentimi/ndjekja e programit përcaktohet në rregulloren e programit të studimit [Evidencë 9, Neni 9, fq. 4], rregulloren e përgjithshme [Evidencë 6], rregulloren Didaktike [Evidencë 7], si dhe risillen brenda syllabusit të çdo lënde [Evidencë 42-57]:</p> <p>Studenti që mungon në 25% të orëve të lëndës duhet të ndjekë përsëri lëndën gjatë vitit të ardhshëm. Secili syllabus përmban informacion në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Emri, kodi dhe kategoria e lëndës;</i> • <i>Pozicioni i lëndës në afatin trevjecar (vit+semestër);</i> • <i>ECTS të lëndës dhe vlerat e krediteve;</i> • <i>Kategoria e lëndës (A, B, C, D apo E);</i> • <i>Përcaktimin nëse është lëndë e detyrueshme apo me zgjedhje;</i> <p>Në çdo syllabus, gjithashtu, jepet informacion i detajuar mbi format e kontrollit të dijes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Testimet e ndërmjetme;</i> • <i>Laboratoret;</i> • <i>Detyrat e kursit;</i>

• *Provimi përfundimtar;*

Në total studenti/ja mund të përfitojë 100 pikë. Sistemi i vlerësimit në Universitetin POLIS bëhet me sistemin me 10 nota. Për çdo vlerësim me notën nga 4(katër) e poshtë, studenti shpallet jokalues dhe është i detyruar ta përsërisë lëndën. Për çdo vlerësim me notën nga 5(pesë) e sipër, studenti shpallet kalues. Vlerësimi përfundimtar do të bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara dhe përqindjeve përkatëse, si më poshtë:

Nota	Përshkrimi	GPA	Nota me Germe Ekuivalente
10	Shkëlqyeshëm	10	A, A+
9	Shumë mirë	9	A- B+
8	Mirë	8	B
7	Kënaqshëm	8	B- C+
6	Mjaftueshëm	7	C C-
5	Kalueshëm	7	D+ D
1-4	Ngelës	5	F

[40.1 Plani mesimore Msc SHK.pdf](#)

[Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf](#)

[Aneks 3 Rregullore Pergjithshme.pdf](#)

[Aneks 4 Rregullore Didaktike.pdf](#)

Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit,

Universiteti POLIS ofron burime të ndryshme për t'i pajisur studentët me informacionet e nevojshme referuar kriterëve të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Këto informacione jepen në:

- Rregulloren e Universitetit POLIS [[Evidencë 6, Neni 47-48, fq. 22](#)]

<p>transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>- Rregulloren e programit të studimit [<u>Evidencë 9, Neni 10, fq. 4</u>]</p> <p>Pranimi në programin e ciklit të dytë të studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e parë Bachelor në fusha të ngjashme ose zotërojnë një diplomë ekuivalente studimi të fituar në vende të tjera të njohura nga autoritetet zyrtare dhe ligjet në fuqi, që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me VKM dhe aplikantët të cilët çertifikojnë nivelin e duhur të anglishtes bazuar në certifikimet ndërkombëtare si TOEFL (IBT 68, CBT 190, PBT 520), IELTS me e madhe se 5.5 etj.</p> <p>Departamenti i Kërkimit Shkencor, bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, përcakton kriteret e pranimit për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkencat Kompjuterike”, si dhe kriteret që do të përdoren për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Kriteret e përcaktuara miratohen nga Dekanati dhe pas miratimit në Senatin Akademik, u vihen në dispozicion Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin para fillimit të aplikimeve për pranime. <i>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” nuk ka pasur asnjë student të transferuar deri tani.</i></p> <p><u>Aneks 3 Rregullore Pergjithshme.pdf</u></p> <p><u>Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf</u></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset e detajuara të çdo lënde [<u>Evidencë 27</u>], hartuar në përputhje me shtojcën Nr. 2 të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018, bazuar në planin mësimor të programit të studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike”, risjellin informacionet e nevojshme për studentët lidhur me organizimin e tyre në leksione/seminare/laboratore, si dhe ngarkesën përkatëse brenda dhe jashtë auditorit.</p> <p><i>Nga materialet e vëna në dispozicion lidhur me syllabuset dhe planet mësimore, GVJ sugjeron që:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Në syllabus-et e lëndëve të paraqiten temat javore me orët përkatëse në cdo javë sipas ndarjes në leksione, seminare, laboratore dhe detyra kursi.

	<p>- Evidentimin në kurrikul dhe në syllabuset e lëndëve të krediteve të dedikuar detyrave të kursit/projekteve (1 ECTS = 1 -2 orë në auditor)</p> <p>Aneks 27 Syllabuse.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Programi i studimit për Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” nuk ka pësuar ndryshime bazuar në legjislacionin në fuqi, pasi programi duhet që të kalojë akreditimin e parë dhe më pas mund të propozojë ndryshime. Ndërkohë, në përputhje me Politikën e Universitetit POLIS [Evidencë 5], për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe <i>Rregulloren e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë</i> [Evidencë 11], bëhet një rishikim vjetor i programit të studimit i cili përfshin vlerësimin e efektivitetit dhe identifikimin e fushave për përmirësim duke përfshirë modifikimet e kurrikulës [Evidencë 107].</p> <p>Syllabuset përditësohen nga stafi i angazhuar në mësimdhënie dhe miratohen nga Departamenti i Kërkimit Shkencor përpara fillimit të çdo semestri për të garantuar përmirësimin dhe përditësimin e informacionit për studentët. Me tej ato ngarkohen në sistemin PITAGORA në dy gjuhe: shqip dhe anglisht.</p> <p>Aneks 2 Strategjia e Zhvillimit 2021-2026.pdf</p> <p>Aneks 8 Rregullore NJBSC.pdf</p> <p>Aneks 30 Tabelat permbledhese per Aneks RVB SHK 01.pdf</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” përmban informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra sipas disiplinave përkatëse, krediteve dhe orëve në auditor dhe jashtë auditorit. Nga materialet e vëna në dispozicion lidhur me syllabuset dhe planet mësimore, <u>GVJ rekomandon:</u></i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Në syllabus-et e të realizohet shperndarja e orëve në auditor së bashku me temat përkatëse për secilën orë referuar secilës kategori: leksion, seminar, laborator dhe detyre kursi.</i> - <i>Të evidentohen në kurrikul dhe në syllabuset e lëndëve të krediteve të dedikuar detyrave të kursit/projekteve (1 ECTS = 1 -2 orë në auditor).</i>


Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) [Evidencë 107]. Viti akademik është i organizuar në 4 semestra dhe përmban 120 ECTS.</p> <p>Përgjatë dy viteve të studimit, me anë të lëndëve të cilat zhvillohen, si Algoritmet e Avancuara, Python, Rrjete dhe Teknologji e avacuar, Machine Learning, studentët përgatiten që të zbatojnë parimet inxhinierike në fushën e shkencave kompjuterike, kërkimit shkencor, por edhe për t’u pajisuar me aftësi për të punuar në grup dhe për të pasur role drejtuesi. Kjo realizohet në përputhje me Rregulloren e programit [Evidencë 9] dhe Misionin dhe Studimin e Tregut të Punës për Programin <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” [Evidencë 14].</p> <p>Aneks 30 Tabelat permbledhese per Aneks RVB SHK 01.pdf</p> <p>Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf</p> <p>Aneks 11 Misioni dhe studimi i tregut Msc.Shkenca Kompjuterike.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të</p>	<p>Lëndët/modulet janë grupuar sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 me ngarkesën përkatëse në kredite, si më poshtë [Evidencë 58, Tabela 9] [Evidencë 71]:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 lëndë bazë (Kategoria A – 12 ECTS – 10 %) - 11 lëndë karakterizuese (Kategoria B – 63 ECTS – 52.5 %) - 2 lëndë ndërdisiplinore/integruese dhe grup-lënde me zgjedhje (kategoria C –15 ECTS – 12.5 %)

<p>nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - 2 lëndë plotësuese (Praktika Profesionale – Kategoria D – 12 ECTS – 10 %) - 1 detyrime përmbyllëse (Mbrojtja e diplomës – Kategoria E – 18 ECTS – 15 %) <p>Detyrimet përmbyllëse (E) parashikojnë mbrojtjen e diplomës, gjithsej 18 ECTS [Evidencë 72]. Shpërndarja e lëndëve në semestra duke filluar nga lëndët formuese në vitin e parë, deri te ato bërthamë në vitin e dytë, e më tej në lëndët me zgjedhje bëhet sipas një rrjedhe logjike të programit përputhur me rezultatet e të nxënit të secilës lëndë.</p> <p>Nisur nga të dhënat e kurrikulës GVJ konstaton se shpërndarja e lëndëve/moduleve në semestral mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të kërkimit shkencor.</p> <p>Aneks 30_Tabela ASCAL Msc CS.pdf 40.2 Tipe veprimtari Msc SHK.pdf 40.1 Plani mesimore Msc SHK.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Struktura e programit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” ka një fokus të madh në aftësitë praktike, duke ofruar një raport të mirë të teorisë dhe praktikës me qëllim ofrimin e metodologjive më efektive për planifikimin, zhvillimin, testimin dhe mirëmbajtjen e softuarit, implementimin e rrjetave të avancuara si dhe machine learning, në përputhje edhe me programe të tjera studimi të suksesshme të Shkencave Kompjuterike. Universiteti POLIS ve në dispozicion infrastrukturën laboratorike për zhvillimin e orëve mësimore duke qenë se 70% e lëndëve kanë natyrë praktike dhe punë laboratorike [Evidencë 72].</p> <p>40.1 Plani mesimore Msc SHK.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve,</p>	<p>Universiteti POLIS duke ofruar një kurrikul të pasur moderne me fokus në pjesët teorike dhe praktike, nxit një shkallë të lartë të punësimit, sidomos në studentët e viteve të dyta. Studentët e programit Msc “<i>Shkenca Kompjuterike</i>” duke u pajisur me aftësi programuese e dizenujuese të softuare-it, nocione dhe implementime të algoritmeve të ndryshme e “machine learning”, bëhen të aftë të punësohen në institucione e kompani të ndryshme apo në ndjekjen e studimeve të niveleve më të larta jo vetëm në</p>




<p>mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>institucione të tjera të arsimit të lartë në Shqipëri, por edhe në universitete ndërkombëtare. Kurrikula e programit Master i Shkencave në “Shkenca Komputerike” [Evidencë 72], duke pasur një përputhshmëri me kurrikulat ndërkombëtare, lehtëson procesin e transferimit të studentëve në një universitet brenda apo jashtë vendit.</p> <p>40.1 Plani mesimore Msc SHK.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Departamenti i Kërkimi Shkencor kujdeset në përditësimin e syllabuseve të lëndëve [Evidencë 27] në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe literaturën bashkëkohore në fushën e studimit. Pedagogët e lëndëve kujdesen të përgatisin materiale mësimore të përditësuara jo vetëm nga ana e përmbajtjes, por edhe në lidhje me metodologjinë, të cilat vihen në dispozicion të studentëve. Ofrimi i programit realizohet në gjuhën shqipe, por një pjesë e konsiderueshme e literaturave ofrohen në gjuhën angleze, duke e bërë edhe më të lehtë përditësimin e literaturës me ato bashkëkohoret të viteve të fundit. Literatura mund të aksesohet fizikisht në bibliotekën e Universitetit POLIS ose në një prej dy bibliotekave dixhitale:</p> <p>(1) http://www.jstor.org</p> <p>(2) https://eds.b.ebscohost.com/</p> <p>Nga vizita në institucion, GVJ konstaton se biblioteka fizike dhe dixhitale plotëson standartet e kërkuara duke qenë e pasur me tituj të fushave të ndryshme.</p> <p><i>Megjithatë, GVJ rekomandon që:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Të përditësohen titujt e rekomanduar të literaturës në syllabus-et e lëndëve me botime të viteve të fundit; - të përditësohet biblioteka e universitetit POLIS me tituj librash të rinj në përputhje me programin e studimit. <p>Aneks 27 Syllabuse.pdf</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” u mundëson dhe u garanton studentëve përftimin e dijeve, fitimin e aftësive dhe kompetencave [Evidencë 9] [Evidencë 107], për t’u punësuar në fushën e shkencave kompjuterike, vendas dhe të huaj, në përputhje me</p>

<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, si dhe ndjekjen e studimeve të ciklit të tretë <i>Doktoraturë</i> në përputhje me profilin e studimit.</p> <p>Departamenti i Kërkimit Shkencor, si pjesë përbërëse e Fakultetit për Kërkim dhe Zhvillim në universitetin POLIS, është në marrëdhënie të vazhdueshme me industrinë, për të përputhur programin e studimit me nevojën e tregut të punës [Evidencë 34]. Si rezultat i bashkëpunimeve ka raste suksesi të punësimit të studentëve në kompani më të cilat Universiteti Polis bashkëpunon, si: Lufthansa Industry Solutions, Alien Studio, Local Web, Raiffaisen bank etj.</p> <p>Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf</p> <p>Aneks 30 Tabelat permbledhese per Aneks RVB SHK 01.pdf</p> <p>Aneks 25 Politika Mbeshtetese dhe Marreveshje bashkepunimi i Msc.pdf</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Organizimi dhe përmbajtja e kurrikulës në module/lëndë në programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” krijon mundësinë për një formim të studentëve si ndërthurje e njohurive teorike dhe praktike të nevojshme, në përputhje me teknologjitë më të fundit të fushës, duke mundësuar integrimin e tyre të shpejtë në tregun e punës, si dhe vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë të Studimeve, Doktoraturë.</i></p> <p><u>GVJ rekomandon që:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - të përditësohet biblioteka e universitetit POLIS me tituj librash të rinj të viteve të fundit në përputhje me programin e studimit; - Të hartohet një raport i mirëfilltë në lidhje literaturën e shtuar se fundmi në bibliotekë. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK) është një njësi e cila asiston dhe ndjek studentët, jo vetëm gjatë ndjekjes së studimeve, por edhe pas mbarimit të saj duke krijuar një bazë të dhënash për karrierën, suksesin dhe vështirësitë e studentëve gjatë përshtatjes në treg [Evidencë 63].</p> <p>Programi i studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” është në procesin e tij të parë të akreditimit dhe rezultatet e sondazhet nuk janë ende të disponueshme.</p> <p>Gjithashtu, në Fakultetin për Kërkimit dhe Zhvillim, bëhen analiza në nivel fakulteti dhe departamenti për ecurinë e programeve të studimit, duke marrë në konsideratë mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës dhe studentëve. Misioni i këtij formimi është të sigurojë që programet e studimit përmbushin kërkesat e sektorit privat e të përditësojë kurrikulat në mënyrë të tillë që t’u ofrojë studentëve aftësitë e nevojshme për të qenë të aftë në tregun kombëtar dhe atë ndërkombëtar.</p> <p><i>Nga dokumentat e vëna në dispozicion, GVJ konstaton se njësia bazë nuk ka paraqitur një studim të mirëfilltë të tregut të punës për programin e studimit.</i></p> <p>Aneks 35_Rregullore ZMSKK.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni mban kontakte të vazhduara me studentët, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit dhe mentorëve të programit të studimit [Evidencë 9], [Evidencë 85] si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor [Evidencë 31].</p> <p>Pranë Departamentit të Kërkimit Shkencor, përfshirja e studentëve në përmirësimin e programit të studimit kryhen në disa drejtime:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Njëpërmjet përfshirjes në senatin akademik, organin më të lartë vendimmarrës, të kryetarit të këshillit studentor dhe nënkryetarit të parë;

	<p>2. Përfshirja në Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë të të një anëtari Alumni;</p> <p>3. Nëpërmjet sondazhit të vlerësimit të pedagogëve të lëndës [Evidencë 23];</p> <p>4. Nëpërmjet takimeve me studentet e diplomuar të cilët ndajnë eksperiencën profesionale në tregun e punës dhe shprehin sugjerimet për përditësime apo përmirësime që mund t'i bëhen kurrikulës për t'iu përshtatur tregut të punës;</p> <p>U_POLIS përfshin studentët në kërkimin shkencor duke i nxitur ata të marrin pjesë në konferenca, workshope, botime akademike e revista shkencore. Nga takimi i GVJ i zhvilluar me studentët u konstatua një përfshirje dhe interes i tyre në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, duke qenë se shumë prej tyre ishin të punësuar, ose ishin të punësuar pas zhvillimit të praktikave mësimore nga Institucione, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre në fushat e shkencave kompjuterike si programimi, rrjete kompjuterike, menxhim bazash të dhënash apo “machine learning”.</p> <p>Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf</p> <p>Aneks 52 Procesverbal.pdf</p> <p>Aneks 20 Pyetesor Alumni.pdf</p> <p>Aneks 17.4 Pyetesor per vleresimin e pedagogut nga studentet.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Departamenti i Kërkimit Shkencor ka autonomi organizative për t'iu angazhuar vazhdimisht në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare [Evidencë 4, neni 8, fq. 7], duke ofruar mundësi për krijimin e rrjeteve dhe nënshkrimin e Memorandumeve të Mirëkuptimit (MoU) me institucione publike/jopublike, institucione të arsimit të lartë kombëtare/ndërkombëtare apo organizata të ndryshme [Evidencë 34].</p> <p>Ky bashkëpunim ka qenë i frytshëm në kuadër të hartimit të programit të studimit, duke sjell një kurrikul, e cila i plotëson nevojat e tregut nga pikëpamja e përmbajtjes dhe e zbatimit të tij. Nga takimet e zhvilluara nga GVJ u konstatua, që ky bashkëpunim është i vazhdueshëm nga ana e institucionit dhe do të mundësojë ruajtjen e cilësisë së programit të studimit dhe lidhjen e ngushtë të tij me tregun e punës.</p>

	Aneks 1_Statuti i Universitetit POLIS.pdf			
	Aneks 25_Politika Mbeshtetese dhe Marreveshje bashkepunimi i Msc.pdf			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Institucioni nxit përfshirjen e studentëve dhe institucioneve partnere në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit të ofruara, duke dëshmuar një përmirësim të vazhduar të ofertës së tij akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>Programi i studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterik”, ofrohet në përputhje të plotë me strategjitë e Universitetit POLIS për të përgatitur studentë me një karrierë të mirë profesionale [Evidencë 15] [Evidencë 4] [Evidencë 5].</p> <p>Objektivat kryesore të këtij programi studimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pajisja e studentëve me njohuri të thelluar teorike dhe shkencore dhe aftësi kërkimore shkencore dhe profesionale në fushën e informatikës dhe teknologjisë së informacionit; - Studenti të jetë i aftë të njohë fushat pilar të shkencave kompjuterike si: algoritmika e avancuar, projektimi i sistemeve kompjuterike, strukturave të të dhënave, sistemeve multimediale, të njohë konceptet kryesore të aspekteve të sigurisë dhe ‘cyber security’ dhe në përdorimin e inteligjencës artificiale e “machine learning”. - Përgatitja e tyre për të arritur një karrierë të sukseshme profesionale apo akademike; - Përgatitja e tyre për të pasur aftësinë për të punuar në grup apo për të marrë role drejtuese.
	Aneks 12_Strategjia e Zhvillimit Msc. Shkenca Kompjuterike_al_en.pdf


	<p>Aneks 1 Statuti i Universitetit POLIS.pdf</p> <p>Aneks 2 Strategjia e Zhvillimit 2021-2026.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Departamenti i Kërkimit Shkencor, si pjesë e Fakultetit për Kërkim dhe Zhvillim është përgjegjës për sigurimin e kërkesave dhe standardeve të nevojshme të mësimdhënies. Stafi akademik vepron në liri të plotë dhe të pavarur akademike, në përputhje me Statutin e Universitetit POLIS [Evidencë 4], Rregulloren e Përgjithshme të tij [Evidencë 6] dhe në përputhje me Rregulloren e Programit të Studimit [Evidencë 9].</p> <p>Departamenti nxit dhe mbështet stafin akademik drejt kërkimit shkencor, në pjesëmarrje në konferenca e publikime në revista kombëtare e ndërkombëtare [Evidencë 16] [Evidencë 30] [Evidencë 33].</p> <p>Fakulteti harton raporte vjetore për të kryer një analizë të kërkimit shkencor për atë vit akademik dhe gjithashtu ka hartuar një axhendë lidhur me kërkimin shkencor për periudhën 2023-2027 [Evidencë 30]. Nga vizita në institucion dhe takimi me stafin akademik, GVJ konsaton se insitucioni i mbeshtet dhe i suporton financiarisht stafin akademik për punblkim në revista ndërkombëtare të indeksuara në SCOPUS.</p> <p>Aneks 1 Statuti i Universitetit POLIS.pdf</p> <p>Aneks 3 Rregullore Pergjithshme.pdf</p> <p>Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf</p> <p>Aneks 13 Kerkimi Shkencor.pdf</p> <p>Aneks 21 Axhenda e Kerkimit Shkencor Research Agenda 2023-2027.pdf</p> <p>Aneks 24 Politika ne mbeshtetje te stafit per kerkimin shkencor.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” motivon e inkurajon studentët të përfshihen në studime, ose aktivitete shkencore. Për me tepër bashkëpunimi me institucionet partnere u ofron studentëve mundësinë të aftësohen në punë të ndryshme ku kryejnë intershipet apo edhe punësohen më tej [Evidencë 34].</p>

	<p>Universiteti POLIS nxit pjesëmarrjen e tij në projekte dhe mobilitete ndërkombëtare [Evidencë 68]. GVJ nga vizita në Institucion dhe nga takimi me grupin e studentëve konstatoi se ata ishin të përfshirë në pjesëmarrje konferencash të organizuar nga Universiteti Polis dhe një pjesë e tyre ishin të punësuar tashmë nga kompani partnere si Lufthansa Solution.</p> <p><i>GVJ konstaton që asnjë student nga ky program nuk ka marrë pjesë në mobilitete të financuar nga IAL-ja apo projekte ndërkombëtare.</i></p> <p><u>Aneks 25 Politika Mbeshtetese dhe Marreveshje bashkepunimi i Msc.pdf</u></p> <p><u>Aneks 39 Lista e studenteve te angazhuar ne projekt.pdf</u></p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Departamenti i Kërkimit Shkencor, si pjesë e Fakultetit për Kërkim dhe Zhvillim, angazhohet për të realizuar aktivitete studimore, kërkimore shkencore. Departamenti organizon workshop-e, leksione të hapura dhe bashkëpunime institucionale. Universiteti POLIS motivon stafin e tij akademik për pjesëmarrje në Konferenca dhe publikime në revista kombëtare apo ndërkombëtare [Evidencë 29] me anë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bashkëpunimeve nga projektet e përbashkëta me partnerë ndërkombëtarë; - Burime të brendshme të universitetit, duke i alokuar çdo stafi akademik mbështetje financiare për kërkimin shkencor, pjesëmarrje në konferenca apo ëorkshope, publikim librash. Plani i shpenzimeve për mbështetje financiare hartohet një herë në vit. <p>Universiteti POLIS ndjek politika mbështetje të stafit kërkimor shkencor në mënyrë të tillë që buxheti i parashikuar për këtë zë, ndahet në mënyrë të barabartë mes anëtarëve të departamentit. Nëse ka buxhet të papërdorur nga ndonjëri nga stafi akademik, ai nuk u rialokohet të tjerëve. Instancat përkatëse vendimmarrëse për aprovimin e një kërkese financimi për një pjesëmarrje në konferencë apo botim artikulli janë [Evidencë 33]:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgjegjësi i Departamentit/ Dekani i Fakultetit; - Përgjegjësi i financave;

	<ul style="list-style-type: none"> - Bordi Administrativ; - Administrator sh.p.k; <p>Në mënyrë që stafi të përfitojë mbështetje financiare duhet që të plotësojë hapat e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Plotësimi i formularit të kërkesës së paku dy javë para zhvillimit të aktivitetit; - Dorëzimi i abstraktit dhe letra e pranimi; - Dorëzimi i punimit të plotë në dekanat, në formë elektronike dhe fizike. <p><u>Aneks 24 Politika ne mbeshtetje te stafit per kerkimin shkencor.pdf</u></p> <p><u>Aneks 21 Axxhenda e Kerkimit Shkencor Research Agenda 2023-2027.pdf</u></p> <p><u>Aneks 22 Raport Vjetor kerkimi shkencor 22-23.pdf</u></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton që asnjë student nga ky program studimi nuk ka marrë pjesë në mobilitete të financuara nga IAL-ja apo projekte ndërkombëtare.</i></p> <p><i><u>GVJ rekomandon</u> të nxitet pjesëmarrja e studentëve në mobilitete.</i></p> <p><i>GVJ nga vizita në Institucion dhe nga takimi me grupin e studentëve konstatoi se ata ishin të përfshirë në pjesëmarrje konferencash të organizuar nga Universiteti Polis dhe një pjesë e tyre ishin të punësuar tashmë nga kompani partnere si Lufthansa Solution.</i></p> <p><i>GVJ konsaton se insitucioni i mbështet dhe i suporton financiarisht stafin akademik për punblkim në revista ndërkombëtare të indeksuara në SCOPUS.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.





Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Departamenti i Kërkimit Shkencor në Universitetin POLIS, mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore. Duke pasur marrëdhëne bashkëpunimi me struktura të tjera kërkimore, programi i studimit “Shkenca Kompjuterike”, organizon lëndët në mënyrë të tillë ku i kushtohet vëmendje e vecantë anës praktike. Në kurrikulën e programit [Evidencë 72] është e përfshirë një lëndë specifike që është tërësisht praktike e emëtuar “Laborator i Integruar në Shkenca Kompjuterike”, e cila zhvillohet në kompaninë Motometech për t’u dhënë mundësinë studentëve të përshihen sa më shumë në anën praktike të aplikimit të shkencave kompjuterike. Gjithshtu në kuadër të projektit ConnecIT [Evidencë 47], kompania GIZ Albania u ka ofruar mundësinë studentëve të këtij programi që të zhvillojnë praktiken e lëndës Sisteme Inteligjente Multimediale pranë këtij institucioni.</p> <p>40.1 Plani mesimorë Msc SHK.pdf</p> <p>Projekti Connect it.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>DKSH, si pjesë e Fakultetit për Kërkim dhe Zhvillim, harton dhe kryen analiza vjetore në kuadër të ecurisë së kërkimit shkencor apo projekteve. Angazhimi ndodh në nivel akademik, studentor, në nivel departamenti, fakulteti e uniersiteti. Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Insititucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore të tij, Universiteti POLIS, zbaton politika të brendshme për të inkurajuar stafin drejt kërkimit shkencor apo aplikimet për projekte të ndryshme kombëtare/ndërkombëtare. Sipar raportit vjetor të kërkimit shkencor të organizuar nga Departamenti vërehet përfshirje në pjesëmarrje në konferenca apo publikime të stafit akademik dhe studentëve [Evidencë 29]. Departamenti harton gjithashtu edhe planin e vitit të ardhshëm akademik referuar kërkimit shkencor [Evidencë 30].</p>
	<p>Aneks 22 Raport Vjetor kerkimi shkencor 22-23.pdf</p> <p>Aneks 21 Axhenda e Kerkimit Shkencor Research Agenda 2023-2027.pdf</p>




<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Departamenti i Kërkimit Shkencor, në bashkëpunim me Qendrën Kërkimore të Qëndrueshmërisë hartojnë planin vjetor të kërkimit shkencor [Evidencë 30], në të cilin përfshihen aktivitete të ndryshme shkencore si [Evidencë 83] [Evidencë 84]:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konferenca (Konferenca Studentore për Shkenca Kompjuterike); - Seri periodike shkencore; - Leksione të hapura; - Forume; - Trajnime për stafin akademik e studentët; <p>Universiteti POLIS, për të inkurajuar sa më tepër stafin akademik dhe studentët për arritjen e objektivave:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Organizon Konferencen vjetore studentore. Konferenca e vitit 2023 me temë “<i>Digital Pionners in the Transformation Era; A Student-led Computer</i>” u organizuar në datën 5 dhjetor; - Boton një seri Periodikesh si: <ul style="list-style-type: none"> (1) Forum Arkitekture+Planifikim http://forumap.org/; (2) TGëeb http://tg-web.eu/publications/; (3) MAD Magazine https://issuu.com/polisuniversity/docs/m.a.d_magazine_2; - Ka një njësi botimi të quajtur <i>Njësia e Botimit Polis-Press</i>, e cila boton tekste teorike apo përkthime në marrëveshje me autorët http://ëëë.universitetipolis.edu.al/?q=en/node/175 <p><u>Aneks 21 Axhenda e Kerkimit Shkencor Research Agenda 2023-2027.pdf</u></p> <p><u>Aneks 55.2 Kalendar i aktiviteteve FKZH 22-23.pdf</u></p> <p><u>Aneks 55.1 Kalendar i aktiviteteve FKZH 23-24.pdf</u></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi i studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” ofron një kurrikul bashkëkohore të përshtatur sipas nevojave tregut të punës duke formuar kështu profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe atë ndërkombëtar [Evidencë 72]. Nga vizita në institucion dhe takimi me studentët, GVJ konstatoi se pjesa më e madhe e studentëve ishin tashmë të punësuar në institucionet partnere apo edhe në kompani të tjera.</p> <p><i>Shembuj nga takimi i GVJ mund të përmendim studentët O. D. dhe D. L. që janë tashmë të punësuar pranë Lutthansa Solutions.</i></p>

	<p>Ndërkohë pas mentorimit tek Tirana Inc, ku u Universiteti Polis ishte organizator, Studenti A. M. ka ndërtuar studion e tij Alien Studio ku merret me programim dhe Web Design. Një pjesë tjetër studentësh janë të punësuar te Posta Shqipëtare, OST, TVSH etj.</p> <p>40.1 Plani mesimore Msc SHK.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Departamenti i Kërkimit Shkencor ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme akademike ose biznesi si: InfoSoft, AADF, Albtelecom sha, Abisnet, Balfin, Crystal Systems, Green Leaf, TeamSystem etj. Këto marrëveshje janë nënshkruar në kuadër të praktikave profesionale, Shkëmbimit të Kapaciteteve dhe Njohurive Teknike, partnere & bashkëpunëtorë në projekte. [Evidencë 34] [Evidencë 72] [Evidencë 86]. Institucioni merr në konsideratë rekomandimet e nxjerra nga këto bashkëpunime, për të përmirësuar kurrikulën, sipas akteve ligjore ne fuqi.</p> <p>Aneks 42 Institucionet dhe organizatat ne bashkepunim ne nivel institucional.pdf</p> <p>Aneks 25 Politika Mbeshtetese dhe Marreveshje bashkepunimi i Msc.pdf</p> <p>Aneks 54 Marreveshjet aktive për programin e studimit.pdf</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Nuk Aplikohet</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <p>- <i>Njësia përgjegjëse angazhohet për të garantuar njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor, duke</i></p>

	<p><i>organizuar konferenca për të nxitur kërkimin shkencor të stafit akademik dhe studentëve.</i></p> <p><i>- Programi i studimit përgatit profesionistë konkurues në tregun e punës;</i></p> <p><i>- Mbështet dhe angazhon përfshirjen e personelit akademik dhe studentëve në kërkimet shkencore.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
<p>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Universiteti POLIS si pjesë e misionit të tij, ka krijimin, zhvillimin dhe transmetimin e njohurive përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe atij të aplikuar, si dhe inovacionit [Evidencë 6, Kapitulli 1, Neni 3].</p> <p>Në një sërë dokumentash që i janë paraqitur GVJ, si “Statuti i Universitetit POLIS” [Evidencë 4], “Strategjia e Zhvillimit 2021-2026” [Evidencë 5], “Vlerësimi performancës së personelit akademik” [Evidencë 21], [Evidencë 22], [Evidencë 22], “Rregullorja Didaktike” [Evidencë 7], “Rregullorja e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë” [Evidencë 8] etj. paraqiten prioritetet të tilla si: Inovacioni dhe kreativiteti i</p>

	<p>burimeve tona njerëzore; rritja e mbështetjes për ekselencë në mësimdhënie etj.</p> <p>Gjithashtu, në kuadër të orëve të hapura, të planifikuara nga departamenti, aktorë të ndryshëm nga industria apo universitetet partnere ndërkombëtare ftohen dhe ndajnë me studentët ekspertizat e tyre [Evidencë 84].</p> <p>Ngarkesa në auditor e studentëve [Tabela 13] është e organizuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - leksione (328 orë); - seminare (217 orë); - ushtrime/laboratorë (306 orë); - forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor (132 orë); - praktikë profesionale (100 orë); - udhëheqje teze diplome/konsultime për provimin përfundimtar të formimit (304 orë); - totali 1387 orë; <p>Metodologjitë e mësimdhënies së përdorura në programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” përshkruhen në Planprogramin e lëndëve në “Kurrikulën e programit të studimit të programit” [Evidencë 107], ku përfshihen aktivitetet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione në auditor; - Seminare të cilat mund të organizohen në auditor apo laborator; - Laboratore; - Seanca praktike profesionale të zhvilluara në auditor - Prezantime në baza javore për lëndët për lëndët e bazës së projektit; - Detyra javore; - Leksionet të hapura; <p>Aneks 3_Rregullore Pergjithshme.pdf</p> <p>Aneks 1_Statuti i Universitetit POLIS.pdf</p> <p>Aneks 2_Strategjia e Zhvillimit 2021-2026.pdf</p> <p>Aneks 17.1_Vleresimi i kolegut per kolegun.pdf</p> <p>Aneks 17.3_Vetevleresim i performances se lektorit.pdf</p>
--	--

	<p>Aneks 17.4 Pyetesor per vleresimin e pedagogut nga studentet.pdf</p> <p>Aneks 4 Rregullore Didaktike.pdf</p> <p>Aneks 8 Rregullore NJBSC.pdf</p> <p>Aneks 55.1 Kalendari i aktiviteteve FKZH 23-24.pdf</p> <p>Aneks 30 Tabelat permbledhese per Aneks RVB SHK 01.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Mësimdhënia në programin e studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” është kombinim i njohurive teorike me një komponent të fortë të praktikës profesionale [Evidencë 72], e cila synon të vendosë studentët në situata reale me të cilat do të ndeshen gjatë aktivitetit të tyre profesional.</p> <p>Programi është propozuar për t’ju përgjigjur nevojës për specialistë në fushën e shkencave kompjuterike, teknologjisë informacionit, programimit apo inteligjencës artificiale mbi bazën e kërkesave të punëdhënësve dhe si një thellim i ciklit Bachelor të propozuar nga Fakulteti i Kërkimi Shkencor.</p> <p>Personeli akademik ka vëmendje të veçantë në përshtatjen e metodave të mësimdhënies në përputhje me nevojat e studentëve. Departamenti i Kërkimit Shkencor parashikon gjatë gjithë vitit akademik konsulta të vazhduara të pedagogëve me studentët për plotësimin e nevojave të tyre [Evidencë 12, neni 9, faqe 4]. Studentët gjithashtu mund të kontaktojnë koordinatorin e tyre akademik për të vepruar si ndërmjetës në zgjidhjen e problemeve të ndryshme në kuadrin e mësimdhënies. Disa nga format kryesore të mësimdhënies që Universiteti POLIS përdor janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <u>Puna në grup.</u> Staf i akademik i organizon seminarët, orët e laboratorit apo praktike në punë në grup në mënyrë që të rrisë te studentët aftësitë e bashkëpunimit dhe negocimit, shkëmbimit të eksperiencave, ndarjes së detyrave; <u>Prezantime/ekspozime publike.</u> Secilës lëndë i caktohet si kriter vlerësues edhe një detyrë e cila duhet të mbrohet me prezantim, e cila synon të përmirësojë dhe rrisë cilësinë e teknikave të prezantimit te studenti, për ta bërë atë më konkurrues në tregun e punës; <u>Forume te hapura.</u> Universiteti vazhdimisht organizon leksione të hapura në të cilat kryen prezantime studimesh,

	<p>kërkimesh apo projektesh e që më pas ndiqen nga një sesion pyetjesh dhe diskutimi nga pjesëmarrësit në aktivitet.</p> <p>d. <i>Sturdy Visit</i>. Format e mesimdhënies në auditor integrohen me ato jashtë auditorit, në kompanitë partnere të fushës si iKub, Fast Tech, Motomtech [<u>Evidencë 75</u>].</p> <p><u>40.1 Plani mesimore Msc SHK.pdf</u></p> <p><u>Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf</u></p> <p><u>Aneks 48 Raporti Vjetor 2022-2023.pdf</u></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Universiteti POLIS, dhe në mënyrë të veçantë Departamenti i Kërkimit Shkencor, mbështetin personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Asistimi i personelit akademik me më pak përvojë në përmirësimin e performancës së tij përbën një nga orientimet prioritare të Departamentit të Kërkimit Shkencor. Kontaktet me institucione të huaja të arsimit të lartë dhe shkëmbimi i personelit akademik (programet Erasmus+) [<u>Evidencë 65</u>] i kanë shërbyer përmirësimit të metodave të mësimdhënies dhe rritjes së kapaciteteve didaktike.</p> <p>Institucioni ndjek politika të tilla, që ofron trajnime të ndryshme apo leksione të hapura për të mbështetur stafin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mësimdhënies [<u>Evidencë 34</u>].</p> <p>Stafi akademik inkurajohet duke u mbështetur financiarisht për pjesëmarrje në konferenca kombëtare/ndërkombëtare apo publikime në revista, për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe për të rritur interesin e tyre në kërkimin shkencor [<u>Evidencë 33, Evidencë 29, Evidencë 68</u>].</p> <p>Për përmirësimin e zhvillimit të procesit mesimor, Departamenti i Kërkimit Shkencor ofron infrastrukturë të konsoliduar IT për Shërbimet Mësimore duke përmendur (1) Sistemin PITAGORA; (2) Rrjetin; (3) Shërbimet Google; (4) Mirëmbajtja e pajisjeve dhe përmirësimet e programit etj.</p>
	<p><u>Aneks 38 Lista e stafit te angazhuar ne projekte.pdf</u></p> <p><u>Aneks 25 Politika Mbeshtetese dhe Marreveshje bashkepunimi i Msc.pdf</u></p>




	<p>Aneks 24 Politika ne mbeshtetje te stafit per kerkimin shkencor.pdf</p> <p>Aneks 22 Raport Vjetor kerkimi shkencor 22-23.pdf</p> <p>Aneks 39 Lista e studenteve te angazhuar ne projekt.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mesimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mesimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Në programin e studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” është i angazhuar në mesimdhënie staf akademik i kualifikuar, me eksperiencë akademike dhe profesionale të fituar ndër vite gjatë punës në universitete dhe në Institucione të tjera të profilit, duke sjellë eksperiencën e tyre si mesimdhënës në Universitetin POLIS [Evidencë 78] [Evidencë 6, Neni 73-74, faqe 32].</p> <p>Aplikanti për staf akademik vlerësohet për kompetencat e tij përmes plotësimit të një “Formularin e Vlerësimi” për këtë kandidat [Evidencë 78], ku analizohen rezultatet shkencore, metodologjia e prezantuar, aftësitë komunikuese, arritjet e kandidatit në ekspertizën e tij/saj të mesimdhënies dhe entuziazmin e kandidatit/es. Departamenti është përgjegjës që të bëjë shpërndarjen e ngarkesës mesimore në përputhje me fushën e ekspertizës së stafit akademik [Evidencë 107], [Evidencë 90-106].</p> <p>Pedagogët përdorin metoda interaktive gjatë zhvillimit të lëndëve me qëllim arritjen e bashkëpunimit, si dhe përmirësimin e njohurive duke futur edhe koncepte të reja nga fusha teknologjike dhe ajo e zbatimit të tyre për të nxitur interesin dhe vullnetin e studentëve.</p> <p>Aneks 47 Formular vlerësimi gjatë procesit të rekrutimit.pdf</p> <p>Aneks 3 Rregullore Pergjithshme.pdf</p> <p>Aneks 30 Tabelat permbledhese per</p> <p>Aneks RVB SHK 01.pdf</p> <p>CV's of academic staff.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mesimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe</p>	<p>Departamenti i Kërkimit Shkencor kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mesimdhënies. Në këtë kuadër një rëndësi të veçantë kanë edhe sugjerimet që vijnë nga studentët dhe të diplomuarit përmes kontakteve me ta, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatores të programit të studimit [Evidencë 72] [Evidencë 9], si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes:</p>

<p>duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor nga studentët (me peshë 50 %) [Evidencë 23]; - Vlerësimi nga kolegët (me peshë 35% [Evidencë 22]; - Vetëvlerësimi (me peshë 15%) [Evidencë 21]; - Vlerësimi nga drejtuesit. <p>Varësisht rezultateve të pyetësorit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgjegjësi i Departamentit përgatit një Raport të detajuar dhe Plan Veprimi, i cili i përcillet Zyrës së Rektoratit dhe Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë [Evidencë 11]; - Përgjegjësi zhvillon takime individuale me pedagogët vlerësimi i të cilëve është nën mesatare apo që kanë komente shqetësuese nga studentët; - Organizohen trajnime dhe seminare të ndryshme në kuadër të përmirësimit të mësimdhënies. <p><u>40.1 Plani mesimore Msc SHK.pdf</u></p> <p><u>Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf</u></p> <p><u>Aneks 17.1 Vlerësimi i kolegut për kolegun.pdf</u></p> <p><u>Aneks 17.3 Vetëvlerësim i performances së lektorit.pdf</u></p> <p><u>Aneks 17.4 Pyetësor për vlerësimin e pedagogut nga studentet.pdf</u></p> <p><u>Aneks 8 Rregullore NJBSC.pdf</u></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin</p>	<p>Në Universitetin POLIS [Evidencë 4] funksionon Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë në përputhje me Legjislacionin e Arsimit të Lartë, njësi e cila është e përbërë nga 9 anëtarë, nga të cilët 5 staf akademik pa kompetenca ekzekutive që i përkasin të tre fakulteteve përkatëse: Fakulteti për Këkim dhe Zhvillim, Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn (FAD) dhe Fakulteti Planifikim Mjedis dhe Menaxhim Urban (FPMMU)</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 përfaqësues nga Sekretaria mësimore - 1 përfaqësues i studentëve - 1 përfaqësues nga komuniteti i biznesit - 1 përfaqësues Alumni [Evidencë 11, neni 7, faqe 4].

dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.

Këto struktura promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet me njësinë kryesore dhe njësinë bazë në shërbim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Në këtë kuadër janë hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies në bazë të fushave të ndryshme të studimit dhe lëndëve specifike [Evidencë 7].

Departamenti i Kërkimit Shkencor monitoron rregullisht procesin e mësimdhënies/mësimnxënies dhe atë të vlerësimit të studentëve dhe analizon periodikisht situatën duke propozuar përmirësime dhe duke ofruar mbështetje për stafin akademik [Evidencë 11].

NJBSC kryen procesin e vlerësimit të stafit akademik, stafit administrativ, vlerësimin e infrastrukturës dhe logjistikës përmes pyetësorëve drejtuar studentëve, formularëve të vlerësimit dhe vetëvlerësimit [Evidencë 21] [Evidencë 22] [Evidencë 23]. Ky proces kryhet në nivel horizontal dhe vertikal. Departamenti harton një raport vlerësimi për stafin akademik [Evidencë 21], të cilin ia përcjell Dekanit. Me tej Dekani informon stafin akademik dhe administrativ për rezultatet. NJBSC në fillim të çdo viti akademik realizon Kalendarin e Ngjarjeve dhe Aktiviteteve për të kryer trajnime të rregullta për zhvillimin profesional të stafit mësimdhënës [Evidencë 84], nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra e Kërkimeve dhe Projekteve, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të metodave të reja dhe inovative në mësimdhënie si dhe eksperimentimin në këtë fushë [Evidencë 5, Evidencë 9].

[Aneks 1 Statuti i Universitetit POLIS.pdf](#)

[Aneks 8 Rregullore NJBSC.pdf](#)

[Aneks 4 Rregullore Didaktike.pdf](#)

[Aneks 17.1 Vlerësimi i kolegut për kolegun.pdf](#)

[Aneks 17.3 Vetëvlerësimi i performancës së lektorit.pdf](#)

[Aneks 17.4 Pyetësor për vlerësimin e pedagogut nga studentet.pdf](#)

[Aneks 49 Raporti i vlerësimit të departamentit për stafin akademik.pdf](#)

	<p>Aneks 55.1 <u>Kalendari i aktiviteteve FKZH 23-24.pdf</u></p> <p>Aneks 2 <u>Strategjia e Zhvillimit 2021-2026.pdf</u></p> <p>Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf</p>			
Konkluzione	<p><i>Universiteti POLIS kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Institucioni nxit dhe mbështet stafin akademik në zhvillimin e mësimdhënies me metoda bashkëkohore, në përputhje me programin e studimit, në përshtatje me tregun e punës duke e bërë programin tërheqës për studentët.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Format e kontrollit të dijeve në Departamentin e Kërkimit Shkencor janë provimi me shkrim, me gojë, me detyra kursi/projekte, i kombinuar me seminare ëorkshope, frekuentime e studime laboratorike.</p> <p>Pas përfundimit të procesit të regjistrimit studentët pajisen nga Zyra e Regjistrimit me “Guidën e Studentit” [Evidencë 64], me anë të së cilës informohen mbi politikat, proceset dhe mekanizmat që drejtojnë studimet e tyre. Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen, në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentëve në orën e parë të mësimin [Evidencë 72].</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e</p>	<p>Në rregulloren mësimore [Evidencë 9, Neni 17-29, fq. 6–11], Rregulloren Didaktike [Evidencë 7, Kreu 5, Neni 20], dhe në çdo syllabus, gjithashtu, jepet informacion i detajuar mbi format e kontrollit të dijes [Evidencë 42-57]:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Testimet e ndërmjetme;</i>

lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Laboraret;</i> • <i>Detyrat e kursit;</i> • <i>Provimi përfundimtar;</i> 																																
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Në total studenti/ja mund të përfitojë 100 pikë. Vlerësimi përfundimtar do të bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara dhe përqindjeve përkatëse, si më poshtë:</p>																																
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nota</th> <th>Përshkrimi</th> <th>GPA</th> <th>Nota me Gërme Ekuivalente</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>10</td> <td>Shkëlqyeshëm</td> <td>10</td> <td>A, A+</td> </tr> <tr> <td>9</td> <td>Shumë mirë</td> <td>9</td> <td>A- B+</td> </tr> <tr> <td>8</td> <td>Mirë</td> <td>8</td> <td>B</td> </tr> <tr> <td>7</td> <td>Kënaqshëm</td> <td>8</td> <td>B- C+</td> </tr> <tr> <td>6</td> <td>Mjaftueshëm</td> <td>7</td> <td>C C-</td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>Kalueshëm</td> <td>7</td> <td>D+ D</td> </tr> <tr> <td>1-4</td> <td>Ngelës</td> <td>5</td> <td>F</td> </tr> </tbody> </table> <p>Pedagogu i lëndës ditën e parë të fillimit të lëndës, informon studentët në lidhje me syllabusin e lëndës dhe mënyrën e vlerësimit, duke e ngarkuar syllabusin edhe në sistemin PITAGORA [Evidencë 32]. Pas përfundimit të një procesi testimi dhe vlerësimi, bëhet shpallja e vlerësimit përfundimtar nga pedagogu i lëndës shoqëruar me firmën e tij [Evidencë 7, Kreu V, Neni 37]. Bazuar në Rregulloren e Programit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike”, studenti ka të drejtën e ankimit të notës.</p> <p><i>GVJ konstaton që departamenti nuk ka paraqitur një procedurë në lidhje me ankimin e notës.</i></p> <p><u>Aneks 34 Guida e Studentit.pdf</u></p>	Nota	Përshkrimi	GPA	Nota me Gërme Ekuivalente	10	Shkëlqyeshëm	10	A, A+	9	Shumë mirë	9	A- B+	8	Mirë	8	B	7	Kënaqshëm	8	B- C+	6	Mjaftueshëm	7	C C-	5	Kalueshëm	7	D+ D	1-4	Ngelës	5	F
Nota	Përshkrimi	GPA	Nota me Gërme Ekuivalente																														
10	Shkëlqyeshëm	10	A, A+																														
9	Shumë mirë	9	A- B+																														
8	Mirë	8	B																														
7	Kënaqshëm	8	B- C+																														
6	Mjaftueshëm	7	C C-																														
5	Kalueshëm	7	D+ D																														
1-4	Ngelës	5	F																														




	<p>40.1 Plani mesimorë Msc SHK.pdf</p> <p>Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf</p> <p>Aneks 4 Rregullore Didaktike.pdf</p> <p>Annex 3-Regulation of undergraduate study program.pdf</p> <p>Aneks 19 Manuallet e Përdorimit PITAGORA.pdf</p>			
Konkluzione	<p><i>Institucioni në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përcakton procedurat e testimit dhe vlerësimit të njohurive të fituara nga studentët për çdo lëndë, duke garantuar aftësimin e tyre në përputhje me objektivat e programit të studimit.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që departamenti të hartojë një procedurë në lidhje me ankimimin e notës.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Referuar syllabuseve të lëndëve, vlerësimi përfundimtar pasqyron rezultatet e një kontrolli të ndërmjetëm, që zhvillohet në javën e 7-të apo të 8-të, vlerësimin e kontrollit përfundimtar, vlerësimin e frekuentimit dhe aktivizimit, si dhe vlerësimin për detyra e kursit [Evidencë 42-57].</p> <p>Nga vizita në institucion dhe takimi me GVB, GVJ konstaton se praktika profesionale, vlerësohet mbi bazën përgatitjes dhe prezantimit të një relacioni që përgatitet nga studentët, ndërsa zhvillimi i saj rregullohet bazuar në udhëzimet në Rregulloren Didaktike për praktikën profesionale të programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" [Evidencë 7, Kreu 5, Neni 20]. Studenti prezanton para komisionit të vlerësimit punimin (relacionin) me tematikë të përcaktuar nga personeli akademik që ndjek Praktikën Profesionale. Në këtë</p>

	<p>referim ftohen edhe subjekte private që janë të fushës që mbulon programi i studimit përkatës. Vlerësimi bëhet me notë dhe pasqyrohet në proces-verbalin përkatës.</p> <p><i>Megjithatë nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ vëren se nuk ka një udhëzim për përgatitjen e <u>relacionit praktikës profesionale</u>, ndaj GVJ sugjeron që institucioni të hartojë një “Udhëzues të përgatitjes së relacionit të praktikës profesionale”.</i></p> <p>Aneks 4 Rregullore Didaktike.pdf</p> <p>Syllabuset.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Institucioni nuk ve në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit. Universiteti POLIS vë në zbatim sistemin interaktiv PITAGORA për t’u ofruar studentëve mundësi në lidhje me menaxhimin e procedurave për lëndën, si notat, frekuentimin, transkriptin apo përzgjedhjen e lëndëve duke ofruar transparencë për studentët, pedagogët, koordinatorin dhe drejtuesin e departamentit [Evidencë 32].</p> <p><i>GVJ vëren se programi Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” nuk ka paraqitur një procedurë për anonimitetin e kryerjes së provimeve, ndaj GVJ sugjeron që institucioni të hartojë një procedurë për anonimitetin e kryerjes së provimeve, me anë të sekretimit të provimeve apo të vendosjes se ‘barcod’-eve për të siguruar anonimitetin e studentit gjatë korrigjimit të tezës.</i></p> <p>Aneks 19 Manualet e Perdoritimit PITAGORA.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Departamenti i Kërkimit Shkencor, kujdeset që vlerësimi përfundimtar i lëndës të kryhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Në rregulloren mësimore [Evidencë 9, Neni 17-29, fq. 6–11], Rregulloren Didaktike [Evidencë 7, Kreu 5, Neni 20], dhe në çdo syllabus, gjithashtu, jepet informacion i detajuar mbi format e kontrollit të dijës [Evidencë 42-57]:</p>
	<ul style="list-style-type: none"> • Testimet e ndërmjetme • Laboratoret • Detyrat e kursit

	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Provimi përfundimtar.</i> <p>Në total studenti/ja mund të përfitojë 100 pikë. Vlerësimi përfundimtar do të bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara dhe përqindjeve përkatëse.</p> <p><u>Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf</u></p> <p><u>Aneks 4 Rregullore Didaktike.pdf</u></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, studentëve u shfaqen pikët e marra për cdo komponent të vlerësimit dhe nota përkatëse në mënyrë të automatizuar. Pas shpalljes së rezultateve, pedagogu/ja ua komunikon rezultatet në mënyrë individuale studentëve duke u dhënë sugjerime në lidhje me pikat e tyre të dobëta.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në përputhje me “Rregulloren e Përgjithshme” [Evidencë 6] dhe “Rregulloren Didaktike” [Evidencë 7]:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Gjatë provimit nuk lejohet të komunikohet me asnjë person tjetër, përveçse me personelin akademik të lëndës; 2. Nuk lejohet përdorimi i celularit apo i çdo mjeti tjetër komunikimi ose regjistrimi; 3. Nuk lejohet përdorimi i asnjë materiali mësimor përveç materialeve të lejuara nga personeli akademik i lëndës. Personeli akademik informon studentët dhe asistuesin për materialet që studentët mund të përdorin përpara fillimit të provimit; <p>Në rast se studenti thyen rregullat e provimit, ai ndërpret provimin dhe plotësohet procesverbali për parregullsi në provime nga personeli akademik i lëndës dhe asistuesi përkatës dhe informohet instrukturi i kursit dhe Shefi i Departamentit. Gjithashtu, procesverbalit i bashkëngjitet provimi, i cili vlerësohet me 0 pikë. Universiteti POLIS për të shmangur plagjiaturën e mashtrimin, në “Rregulloren Didaktike” [Evidencë 7, Neni 26] përkrah masat që merren për këtë shkelje disiplinore për projektet apo tezat e diplomave bachelor e master. Për parandalimin e plagjiaturës universiteti përdor</p>




	<p>softuerin <i>Ithenticate</i>, i cili është një ndër softet që ofrohet nga Infrastruktura e Teknologjisë së Informacionit të Universitetit.</p> <p>Aneks 3 Rregullore Pergjithshme.pdf</p> <p>Aneks 4 Rregullore Didaktike.pdf</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në “Rregulloren Didaktike” [Evidencë 7], vlerësimi i provimeve dhe dijeve të studentëve afishohen në një periudhë brenda tre ditësh nga data e kryerjes së provimit.</p> <p>Personeli akademik i hedh notat në sistemin PITAGORA.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin, duke dorëzuar një kërkesë ankimimi notash. Ankesa i drejtohet me shkrim Drejtuesit të Njësisë Kryesore ku bën pjesë studenti, jo më vonë se 5 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. Drejtuesi i Fakultetit për Kërkim dhe Zhvillim ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës. Rishikimi i tezës nga komisioni ad-hoc realizohet në prezencë të studentit dhe personelit akademik të grupit mësimor. Në përfundim të procesit, komisioni mban një procesverbal të veçantë ku pasqyron vendimin e tij për të ndryshuar ose jo vlerësimin e provimit së bashku me arsyetimin përkatës. Departamenti propozon vendimin përfundimtar, i cili përfundimisht caktohet nga Dekanati.</p> <p>Në rastet e ngritjes së një ankimimi prej studentëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komisioni i vlerësimit shqyrton çështjen dhe informon studentin dhe sekretarinë mësimore nëse ka pasur ndryshime në vlerësimin e mëparshëm; - Nëse studenti kërkon ngritjen e një komisioni të posaçëm, ai/ajo informohet në lidhje me përbërjen e komisionit. Vlerësimi i komisionit të posaçëm i bëhet me dijeni studentit/es dhe sekretarisë mësimore; - Proçesi dokumentohet dhe vlerësimi arkivohet. <p>GVJ konstatoi se për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” nuk ka pasur ende raste ankimimi.</p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	

	<p>Procedura e rishikimit të notës përshkruhet qartë në Guidën Studentore [Evidencë 64], Rregulloren e Programit të studimit [Evidencë 9], dhe “Rregullorja Didaktike” [Evidencë 7].</p> <p>GVJ nga vizita në institucion dhe nga dokumentat e vëna në dispozicion konsaton se programi Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” nuk ka pasur raste konkrete të ankimimit.</p> <p><i>RVJ sugjeron që të hartohet një procedurë referuar ankesave për notën të studentëve.</i></p> <p><u>Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf</u></p> <p><u>Aneks 4 Rregullore Didaktike.pdf</u></p>			
Konkluzione	<p><i>Departamenti i Kërkimit Shkencor në rregulloren e programit të studimit përcakton procedura të qarta dhe transparente të vlerësimit të njohurive të studentëve të bazuara në meritë, si dhe ju jep mundësinë studentëve të ankimojnë vlerësimin, duke ngritur komisione ad hoc për shqyrtimin e ankimimit.</i></p> <p><i>Institucioni kujdeset në zhvillimin e aktiviteteve vlerësuese të dijeve me korrektesë, duke mos pranuar kopjen dhe plagjiaturën nga ana e studentëve.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që Njësia Kryesore:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Të hartojë një udhëzim për përgatitjen e relacionit praktikës profesionale;</i> - <i>Të hartohet një “Udhëzues për Provimet”, në të cilin të përcaktohen qartë jo vetëm kriteret e hyrjes në provim dhe mënyrat e vlerësimit por edhe procedurat e ruajtjes së anonimitetit, plagjiaturës.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret


Vlerësimi i ekspertëve




<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit i ciklit të dytë <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike”, siç dëshmohet edhe në “Kurrikulat” e lëndës [Evidencë 72] ka për mision:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. T’u ofrojë studentëve mundësinë që të marrin dhe zhvillojnë dijet, si dhe aftësitë e tyre profesionale në fushën e shkencave kompjuterike; 2. Të nxisë tek studentët të menduarit dhe analizuarit kritik për të kuptuar sfidat në situata të ndryshme të zhvillimit të softueve, të njohjes me algoritmat e avancuara, aspektet e sigurisë së informacionit, programimit, “machine learning” etj; 3. Të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme për të zbatuar në mënyrë efektive aftësitë teknike dhe logjistike në fushën e programimit, inxhinierisë së softuerit, rrjetave kompjuterike, inteligjencës artificiale; <p>40.1 Plani mesimorë Msc SHK.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Natyra e kompetencave të kërkuara në programin e studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit [Evidencë 72], komunikimit dhe ndërveprimit social [Evidencë 71] duke qenë se sektori informatik është në mënyrë të pashmangshme i lidhur me rrjetin ndërkombëtar, kërkon njohje të gjuhës së huaj, si dhe një komunikim intensiv duke shfrytëzuar elementë të avancuar të teknologjisë së informacionit. Për më tepër planprogrami ofron lëndë si: “Menaxhim Projekti” apo lëndë me zgjedhje si “Inteligjenca e biznesit”, “Bashkëveprimi njeri-kompjuter” apo Intershipi të cilat e ndihmojnë studentin në përmirësimin e aftësive të komunikimit dhe ndërveprimit.</p> <p>40.1 Plani mesimorë Msc SHK.pdf</p> <p>40.2 Tipe veprimtari Msc SHK.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik</p>	<p>Gjatë orëve të fundit të mësimin, studentët dorëzojnë detyrat e kursit, punët e laboratorëve, apo zhvillojnë seanca përmbledhëse ushtrimesh, përmes të cilave testojnë njohuritë e marra dhe vetëvlerësojnë përgatitjen e tyre përpara provimit përfundimtar. Në fund të lëndës, bëhet një përmbledhje e argumentave kryesorë dhe diskutim i situatave reale mbi temat e trajtuara.</p>

<p>vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Stafi akademik i Departamentit të Kërkimit Shkencor, si pjesë e Fakultetit për Kërkim dhe Zhvillim kryen procesin e rishikimit të cdo plan programi, në përfundim të çdo semestri akademik me qëllim përmirësimin e kurrikulave sipas kërkesave të tregut. Ky proces menaxhohet nga Departamenti dhe Fakulteti.</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” [Evidencë 72] është hartuar duke ndërthurur orët teorike në auditor me orët praktike në laboratore, dhe praktikën mësimore, duke mundësuar zhvillimin tek studentët e kompetencave profesionale në fushën e shkencave kompjuterike.</p> <p>Një pjesë e detyrave të kursit zhvillohen në grup, me qëllim nxitjen e punës në grup, aftësimin në ndarjen e detyrave, ballafaqimin e rezultateve dhe diskutimin e tyre.</p> <p>Duke organizuar aktivitete të ndryshme si konferenca studentore, bashkëpunim pedagog student në kuadër të kërkimit shkencor, ëorkshope, “hackathone”, etj, Universiteti POLIS nxit dhe zhvillon njohuritë inovative të studentëve [Evidencë 87, Evidencë 88].</p> <p>Studentët kanë akses në infrastrukturën e nevojshme si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Infrastruktura në Funksinin e Programit të Studimit [Evidencë 71]; - Shërbimet e Bibliotekës [Evidencë 80]; - Shërbimet IT [Evidencë 84]. <p>Bashkëpunimet e Departamentit të Kërkimit Shkencor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar kontribuojnë në rritjen e mobiliteteve dhe shkëmbimin e eksperiencave me Institucionet partnere [Evidencë 76, Evidencë 86]. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ai brenda vendit kontribon për rritjen e mobiliteteve dhe shkëmbimin e eksperiencave.</p> <p><i>GVJ, nga evidencat e vëna në dispozicion dhe takimi në institucion, konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Deri më tani në rang ndërkombëtar bëhet fjalë vetëm për mobilitetin e stafit akademik, ndërsa nuk ka pasur mobilitete të studentëve të këtij programi studimi.</i>

	<p><i>GVJ vlerëson kontributin që institucioni jep në kuadër të praktikave profesionale, mbështetjes për studime kërkimore shkencore në thellimin e njohurive, por rekomandon që:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Institucioni të hartojë një strategji për nxitjen e pjesëmarrjes së studentëve në mobilitete.</i> <p><u>40.1 Plani mesimore_Msc_SHK.pdf</u></p> <p><u>Aneks 56 Broshura informuese e konferences studentore.pdf</u></p> <p><u>Aneks 53. Broshura informuese Simpoziumi CS.pdf</u></p> <p><u>Aneks 42 Institucionet dhe organizatat ne bashkepunim ne nivel institucional.pdf</u></p> <p><u>Aneks 54 Marreveshjet aktive për programin e studimit.pdf</u></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Kërkimit Shkencor zhvillon vazhdimisht leksione të hapura me stafin e tij akademik dhe me staf të ftuar duke sjellë tek studentët zhvillimet më të fundit në fushën e shkencave kompjuterike, brenda dhe jashtë vendit [Evidencë 29] [Evidencë 33].</p> <p>Duke konsideruar faktin që një ndër pikat kyçe të MoU që Universiteti POLIS ka nënshkruar me partnerët e tij është organizmi i leksioneve të hapura periodikisht dhe seminareve të organzuara nga drejtorë ekzekutivë të këtyre institucioneve, e bën më të lehtë ekspozimin e vazhdueshëm të studentëve në ide e teknologji inovative [Evidencë 76, Evidencë 86]. Organizimi i këtyre aktiviteteve organizohet në nivel departamenti dhe fakulteti çdo fillim viti akademik [Evidencë 83, Evidencë 84].</p> <p><u>Aneks 22 Raport Vjetor kerkimi shkencor 22-23.pdf</u></p> <p><u>Aneks 24 Politika ne mbeshtetje te stafit per kerkimin shkencor.pdf</u></p> <p><u>Aneks 42 Institucionet dhe organizatat ne bashkepunim ne nivel institucional.pdf</u></p> <p><u>Aneks 54 Marreveshjet aktive për programin e studimit.pdf</u></p> <p><u>Aneks 55.2 Kalendari i aktiviteteve FKZH 22-23.pdf</u></p> <p><u>Aneks 55.1 Kalendari i aktiviteteve FKZH 23-24.pdf</u></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara</p>	<p>Universiteti POLIS, në kuadër të zhvillimit të ideve inovative dhe studimeve të përparuara kërkimore ka ngritur një strukturë</p>




<p>kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>të posacme <i>“Innovation Factory (IF)”</i> nëpërmjet së cilës ofron suport financiar dhe infrastrukturor [Evidencë 20].</p> <p><i>“Innovation Factory”</i> ofron asistencë në disa drejtime:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbështet studentët duke u vënë në dispozicion pajisje më të avancuara për prodhim dixhital; - Asistencë teknike dhe “know-how”; - Duke ofruar trajnime në fushën e inovacionit; - Duke ofruar skema bashkëzhvillimi dhe bashkëfinancimi të projekteve më premtuese. <p>Disa studentë të programit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” janë të angazhuar pranë IF dhe gjithashtu janë pjesë e klubeve të Artificial Intelligence, Web-it apo Robotikës.</p> <p>Aneks 16 Broshura Innovation Factory IF Strategy 2022-2025.pdf</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” është hartuar duke ndërthurur orët teorike në auditor me orët praktike në laboratore, dhe praktikën mësimore, duke mundësuar zhvillimin tek studentët e kompetencave profesionale në fushën e shkencave kompjuterike.</i></p> <p><u>GVJ, rekomandon:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Të nxiten mobilitetet e studentëve të këtij programi studimi; - Të krijohjet një evidencë për infrastrukturën ICT që ofrohet në kuadër të Funkcionimit të Programit të Studimit; - Të pajiset biblioteka me tituj të librave të viteve të fundit të në përputhje me lëndët e programit të studimit; <p><i>GVJ, konstaton se deri më tani në rang ndërkombëtar bëhet fjalë vetëm për mobilitetin e stafit akademik, ndërsa nuk ka pasur mobilitete të studentëve të këtij programi studimi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.5




Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” përcaktohet procedura për zhvillimin e mbrojtjes së diplomës, në të gjitha fazat: aplikimi i temës së diplomës, miratimi i temës, përcaktimin e pedagogut udhëheqës si edhe planit të realizimit të saj [<u>Evidencë 35, Kreu 7</u>].</p> <p>Që një student të kualifikohet në procesin e diplomimit duhet që ai [<u>Evidencë 10</u>]:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në fillim të semestrit të dytë të vitit akademik të paraqesë kërkesën/propozimin për temë e cila miratohet nga Dekani, nëse studenti ka shlyer detyrimet përkatëse; - Të kryejë konsultimet e paracaktuara gjatë procesit të kryerjes së diplomës ; - Të realizojë me sukses Kontrolllet nga Komisioni; - Të dorëzojë punimin final. <p>Programi <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike” nuk e ka akoma brezin e tij të parë të diplomuar. Procedura në lidhje me detyrimeve përveçse janë të përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme dhe në Rregulloren e Diplomimit, publikohet edhe në faqen ëeb të Universitetit POLIS. Studentët që janë në prag diplomimi, informohen gjithashtu edhe me email.</p> <p>Aneks 3_Rregullore Pergjithshme.pdf</p> <p>Aneks 7_Rregullore Diplome Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Departamenti i Kërkimit Shkencor përcakton listën e temave të diplomave (Projektin e Diplomimi) në fillim të semestrit të dytë të vitit akademik [<u>Evidencë 10</u>].</p> <p>Studenti asistohet rregullisht duke iu ofruar informacioni, udhëzimet dhe materialet e nevojshme në kuadër të kërkesave të përmbylljes nga departamenti, koordinatori i programit e nga udhëheqësit e diplomave të cilët ndjekin studentët në metodologjinë e përdorur, bazat teorike dhe zhvillimin e temës.</p> <p>Aneks 7_Rregullore Diplome Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf</p>

<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Nuk është e aplikueshme pasi ende nuk ka një brez të parë të diplomuarish në programin <i>Master i Shkencave</i> në “Shkenca Kompjuterike”</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim ka hartuar një procedurë për përzgjedhjen e temës së diplomës nga ana e studentëve. Filozofia e fakultetit është e tillë që në fillim të semestrit të dytë të vitit të dytë akademik studentët propozojnë vetë fushat e tyre të interesit në lidhje me temat e diplomave të cilat duhet të jenë në përputhje me axhendën e kërkimit shkencor. Në këtë mënyrë i lihet hapësirë studentit për shfaqjen e ideve të reja. Më tej në bashkëpunim me mentorin udhëheqës që përputhet me ekspertizen e nevojshme, studenti kryen punimin e temës së diplomës sipas standarteve kërkuara nga institucioni.</p> <p>Udhëheqësi ndihmon studentin në zhvillimin e idesë fillestare, kryerjen e studimit të literaturës, përcaktimin e metodologjisë, implementimin dhe testimin e rezultateve [Evidencë 16]. Procesi i paraqitjes përfundimtare të temës së diplomës përcaktohet në “Udhëzuesin për shkrimin e tezës” [Evidencë 10]</p> <p>Aneks 13_Kerkimi Shkencor.pdf</p> <p>Aneks 7_Rregullore Diplome Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Departamenti i Kërkimit Shkencor vë në dispozicion të gjithë infrastrukturën shkencore për të inkurajuar studentët drejt kërkimit shkencor, praktikave, apo kryerjeve të implementimeve apo testeve të ndryshme në lidhje me shkencat kompjuterike. Infrastruktura shkencore e ofruar përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Infrastruktura në funksion të programit të studimit; - Shërbimet e bibliotekës [Evidencë 60]; - Shërbimet e IT-së [Evidencë 20]; - Aksesin në burime online të revistave shkencore;

	<p>- Programe softuerike specifike të nevojshme për lëndët e tyre.</p> <p><u>GVJ konstaton që nuk ka një raport të mirëfilltë në lidhje me informacionin me kapacitetet infrastrukturore dhe në lidhje me shërbimet ICT.</u></p> <p><u>Annex 34.3-Information on Library Services.pdf</u></p> <p><u>Aneks 16 Broshura Innovation Factory IF Strategy 2022-2025.pdf</u></p> <p><u>Aneks 29.2 Literatura e CS ne PDF.pdf</u></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Bazuar në “Rregulloren e Diplomimit” [Evidencë 10], diploma ka 18 ECTS, dhe në përfundim të mbrojtjes së saj studenti merr vlerësimin përfundimtar (maksimumi 100 pikë) të saj bazuar në 3 komponentë kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi i oponentit (20% e pikëve totale); 2. Vlerësimi i udhëheqësit (30% e pikëve totale); 3. Vlerësimi i komisionit të diplomës (50% e pikëve totale); <p><u>Aneks 7 Rregullore Diplome Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf</u></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomë “Master i Shkencave” në “Shkenca Kompjuterike” në Fakultetin e Kërkimit dhe Zhvillimit, të Universitetit POLIS, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p> <p>Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit. Bazuar në Rregulloren për studimet universitare [Evidencë 9, Neni 13], studenti i cili ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur diplomën, pajiset me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomën përkatëse; - Suplementin e diplomës; - Certifikata e notave; - Katalogu i përshkrimit të lëndëve. <p>Diploma nënshkruhet me shkrim dore duke shënuar emrin, mbiemrin, gradën dhe titullin shkencor nga Dekani i FKZH përgjegjës për programin e studimit dhe nga Rektori i</p>




	<p>Universitetit POLIS. Me tej diploma vulozet me vulën e njomë dhe të thatë të Universitetit POLIS.</p> <p><u>Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf</u></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit në një arkivë fizike dhe elektronike, dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.</p> <p>Dorëzimi i diplomave kryhet me Ceremoni publike ku marin pjesë autoritete të Universitetit POLIS dhe autoritete të tjera të fushës. Sekretaria mësimore arkivon të dhënat në procesverbalet përkatëse të notave, regjistrin fizik të notave dhe në sistemin elektronik të Universtietit POLIS. Te dhënat arkivohen në formë të veçantë për çdo program studimi në vite [Evidencë 7, Kreu 11].</p> <p><u>Aneks 4 Rregullore Didaktike.pdf</u></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike" përcaktohet procedura për zhvillimin e provimit të gjithëpërfshirës përfundimtar/mbrojtjes së diplomës. Në bazë të kriterit të përmbylljes së të gjitha detyrimeve të planit mësimor, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një teze diplome.</i></p> <p><i>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomë "Master i Shkencave" në "Shkenca Kompjuterike" në Fakultetin e Kërkimit dhe Zhvillimit, të Universitetit POLIS, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</i></p> <p><i>Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	N/A			
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>				
<p>Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>				
<p>Konkluzione</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Polis, GVJ konstaton se departamenti përgjegjës për këtë program studimi mban të dhëna në lidhje me stafin akademik të përfshirë në mësimdhënie, ku përfshihet personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme që angazhohet cdo vit, lëndët që zhvillon secili prej tyre, ngarkesa për cdo disiplinë, ngarkesa semestrale dhe ajo totale [Aneks 30 Tabelat permbledhese per Aneks RVB SHK 01.pdf, tabela 2, 10, 14]. Personeli akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike”, nuk përmbush plotësisht kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik [Aneks 28 CV e stafit te angazhuar ne program.pdf].</p> <p>Nga shyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, janë angazhuar staf akademik në mësimdhënie për dy vite akademike si më poshtë vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 13 staf akademik gjithsej, nga ku 8 janë staf akademik efektiv (PAE) dhe 5 janë staf akademik me kontratë (PAK); 2. Për vitin akademik 2023- 2024 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 14 staf akademik gjithsej, nga ku 8 janë

staf akademik efektiv (PAE) dhe 6 janë staf akademik me kontratë (PAK);

Tituj/grada	2022 – 2023		2023 - 2024	
	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr	1	-	1	-
Prof.As.Dr	-	-	-	-
Dr/PhD	5	2	6	2
Msc	2	3	1	4
Në total	8	5	8	6

Sipas përcaktimeve ligjore (pika 6 neni 59 i Ligjit Nr 80/2015), personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Nga sa më sipër konstatohet se në këtë program studimi Master i Shkencave, angazhohen edhe staf akademik me Msc (25 – 38 %).

GVJ rekomandon që, për realizimin e programit të studimit Institucioni të angazhojë në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën gradën shkencore Dr., në përputhshmëri me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik.

[RVB_MSc.Shkenca_Kompjuterike_al.pdf](#)

[Aneks_28_CV_e_stafit_te_angazhuar_ne_program.pdf](#)

[Aneks_14_Guida_e_stafit_en.pdf](#)

[Aneks_30_Tabelat_permbledhese_per_Aneks_RVB_SHK_01.pdf](#)

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në universitetin Polis, GVJ konstaton se universiteti ka një rregullore të brendshme didaktike në të cilën përcaktohet procedura e ndarjes së ngarkesës. Bazuar në tabelat 12.1, 12.2, [[Aneks 30 Tabelat permbledhese per Aneks RVB SHK 01.pdf](#)] u konstatua se ngarkesa mësimore e personelit akademik për dy vite akademike është si më poshtë vijon:

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2022-2023	585	436	149	74.5% /25.5%
2023-2024	947	608	339	64.2% /35.8%

Nga tabela rezulton që për vitin akademik 2023-2024, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, nuk është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017, ndaj GVJ rekomandon që përballimi i ngarkesës mësimore i programit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” të realizohet në masën 70% nga PAE, në plotësim të standardit të kërkuar.

[Aneks 1_Statuti i Universitetit POLIS.pdf](#)

[Aneks 3_Rregullore Pergjithshme.pdf](#)

[Aneks 4_Rregullore Didaktike.pdf](#)

[Aneks 30_Tabelat pëmbledhese per Aneks_RVB_SHK_01.pdf](#)

Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në POLIS, GVJ konstaton se Universiteti POLIS ka kontrata pune me secilin punonjës të stafit akademik PAE dhe PAK. Çdo fillim viti burimet njerëzore në bashkëpunim me departamentin dhe fakultetin përgjegjës për programin master i shkencave “Shkenca Kompjuterike” përditësojnë listën e personelit akademik. Në zyrën e burimeve njerëzore gjenden dosjet e personelit, në të cilat përfshihen kontratat e punës, raportet e vlerësimit gjatë rekrutimit, cv, diploma, kualifikime etj.

Kohëzgjatja e kontratës së punës për stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshëm ishin me kohë zgjatje të ndryshme, sipas specifikave dhe kategorive të ligjit në fuqi, përkatësisht me kohëzgjatje të pa përcaktuar, njëvjeçare, semestrale etj. Rinovimi i kontratës bëhet në bazë të performances dhe vlerësimit cilësor në fushën e mësimdhënies, punës kërkimore, si dhe duke kontribuar në mbështetjen dhe zhvillimin e institucionit. Qëndrueshmëria e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, verëhet në evidencat e

	<p>ofruara nga IAL-ja, [Aneks 30 Tabelat permbledhese per Aneks RVB SHK 01.pdf] perkatesisht në tabelat 2, 4 dhe 6.</p> <p>Aneks 3 Rregullore Pergjithshme.pdf</p> <p>Aneks 45 Model kontrate PAK-PAE.pdf</p> <p>Aneks 44 Strategjia e Burimeve Njerëzore.pdf</p> <p>Aneks 47 Formular vlerësimi gjatë procesit të rekrutimit.pdf</p> <p>Aneks 46 Formular per shpalljen e vendit kandidat.pdf</p> <p>Informacion nga burimet njerëzore</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar ne RVB-në e paraqitur nga POLIS dhe në varësi të nevojave të departamentit, FKZH i paraqet [Aneks 3 Rregullore Pergjithshme.pdf, Neni 74, 75, 76] zyrës së burimeve njerëzore kërkesën për fillimin e procesit të rekrutimit. Zyra e burimeve njerëzore e shpall vëndin vakant në faqen zyrtare të universitetit, https://universitetipolis.edu.al/. Aplikantët ftohen të dergojnë online dokumentacionin e specifikuar në thirrjen e shpallur.</p> <p>Aneks 3 Rregullore Pergjithshme.pdf</p> <p>Aneks 45 Model kontrate PAK-PAE.pdf</p> <p>Aneks 44 Strategjia e Burimeve Njerëzore.pdf</p> <p>Aneks 47 Formular vlerësimi gjatë procesit të rekrutimit.pdf</p> <p>Aneks 46 Formular per shpalljen e vendit kandidat.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në IAL, personeli ndihmes akademik eshte angazhuar per realizimin e oreve laboratorike. [Aneks 30 Tabelat permbledhese per Aneks RVB SHK 01.pdf], Tabela 1.1, 1.2, 2. Në bashkëpunim me personelin akademik ata përcaktojnë nevojat e laboratorit në lidhje me programin e studimit.</p> <p>RVB_MSc.Shkenca Kompjuterike_al.pdf</p> <p>Aneks 30 Tabelat permbledhese per Aneks RVB SHK 01.pdf, Tabela 1.1, 1.2, 2</p>

<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>GVJ zgjodhi në mënyrë të rastësishme dosje të pedagogëve të brendëshëm dhe të jashtëm, nga ku konsaton se Zyra e Burimeve Njerëzore ka dosjet me dokumentat përkatëse për të gjithë personelin, ku për çdo pedagog të programit disponon të dhënat e kualifikimeve të tij/ të saj, kontratat e punës, dokumente që lidhen me vjetërsinë në punë, të dhëna për zhvillimin e vijueshëm profesional. Çdo vit akademik përditësohen CV e pedagogëve ku pasqyrohen veprimtaritë kërkimore, publikimet dhe konferencat shkencore ku ai/ajo merr pjesë.</p> <p>RVB_MSc.Shkenca_Kompjuterike_al.pdf</p> <p>Aneks 14_Guida e stafit_en.pdf</p> <p>Aneks 28 CV e stafit te angazhuar ne program.pdf</p> <p>Vizita ne IAL</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>U_POLIS ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi në rang universiteti. Janë marrëveshje me universitete kombëtare/ndërkombëtare, institucione ose kompani. Këto marrëveshje shërbejnë për praktikën dhe punësimin e studentëve të këtij program studimi. Kjo listë shërben si një mundësi përzgjedhje nga ana e studentëve. Gjithashtu studentët janë të lirë të zgjedhin vetë vendin ku duan të bëjnë praktikën profesionale. [Aneks 4_Rregullore_Didaktike.pdf, Neni 6]</p> <p>Aneks 25_Politika Mbeshtetese dhe Marreveshje bashkepunimi i Msc.pdf</p> <p>Aneks 37_Lista e projekteve nderkombetare-22-23.pdf</p> <p>Aneks 30_Tabelat permbledhese per Aneks RVB SHK 01.pdf, (Tabela 5)</p> <p>Aneks 4_Rregullore_Didaktike.pdf</p>
<p>Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritis që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve</p>	<p>Kurrikula e programit master shkencor “Shkenca Kompjuterike”, ka në përbërje Praktikën Profesionale sipas ngarkesës së përcaktuar në Ligjin e arsimit të Lartë. [Aneks 4_Rregullore_Didaktike.pdf] POLIS praktikisht e ka të mirëorganizuar procesin e zhvillimit dhe vlerësimit të praktikave profesionale por, GVJ sugjeron që Institucioni të hartojë një “<i>Udhëzim të përgatitjes së relacionit të praktikës</i>”</p>




/raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	<p><i>profesionale”, në mënyrë që studentët ta kenë të qartë mënyrën e organizimit dhe zhvillimit të këtij kursi.</i></p> <p>Aneks 4 Rregullore Didaktike.pdf</p> <p>Aneks 43 Formulari për kryerjen e praktikës-intershipit.pdf</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se në FKZH, personeli akademik efektiv dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush pjesërisht standartet në përputhje me fushën e programit, të mësimdhënies të programit të studimit.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që, për realizimin e programit të studimit Institucioni të angazhojë në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën gradën shkencore Dr., në përputhshmëri me kërkesat ligjore në fuqi.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që Departamenti i Kërkimit Shkencor, si njësisia bazë përgjegjëse të rishikojë shpërndarjen e ngarkesës mësimore midis PAE dhe PAK në këtë program studimi në mënyrë që mbulimi i ngarkesës nga PAE i angazhuar në procesin e mësimdhënies të përputhet tërësisht me standartet e kërkuara që i referohen mbulimit të ngarkesës mësimore (70%)</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që Institucioni të hartojë një “Udhëzim të përgatitjes së relacionit të praktikës profesionale”, në mënyrë që studentët ta kenë të qartë mënyrën e organizimit dhe zhvillimit të këtij kursi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin	U_POLIS ofron një infrastrukturë bashkëkohore në mbështetje të procesit mësimor dhe atij shkencor. Sallat kanë hapësirën e nevojshme për të ushtruar mësimdhënien në kushte të mira dhe komode për studentët. Secili mjedis disponon ajrosjen dhe

<p>e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>ndriçimin e duhur, sistem mbrojtje nga zjarri edhe ajër të kondicionuar. U_POLIS ofron 3 laborator të pajisur me PC, projector dhe Software në mbështetje të programt të studimit.</p> <p>Aktualisht U_POLIS po zgjeron mjediset e tij, duke ndërtuar një kampus modern. Gjithashtu në ambjentet e Polis, gjendet biblioteka fizike, me orare fleksibël në përshtatje të orarit mësimor, dhe biblioteka online të aksesueshme gjatë gjithë kohës.</p> <p><u>1. Siperfaqet POLIS.pdf</u></p> <p><i>Vizita GVJ në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ nga vizita në institucion, konstaton se për programin e studimit Master i Shkencave në 'Shkenca Kompjuterike' ka një laborator të dedikuar për zhvillimin e procesit mësimor. Çdo klasë laborator ku zhvillohen shumica e lëndëve të këtij programi studimi ka kompjuter dhe videoprojektor funksional dhe akses të përhershëm interneti. U_POLIS ofron 3 laboratorë të pajisur me PC, projektorë dhe Software në mbështetje të programit të studimit. Këto mjedise ofrohen për të zhvilluar kryesisht kurset e programimit dhe shkencave kompjuterike, për realizimin e praktikave, detyrave të kursit etj.</p> <p><i>Vizita GVJ në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në ambientet e IAL-së, GVJ konstaton së laboratorët janë të pajisur me aparatura dhe mjete të nevojshme për të trajtuar lëndë të shkencave kompjuterike duke siguruar një mësimdhënie të orientuar nga praktika. Secili kurs i kurrikulës ndërthuret me pjesën praktike, përmes detyrave, projektëve të kursit etj.</p> <p><i>Vizita GVJ në institucion</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në ambientet e IAL-së, GVJ konstaton se U_POLIS ka laborator të dedikuar për programin e studimit, i cili është i pajisur me aparatura dhe mjete të nevojshme për të trajtuar lëndë të shkencave kompjuterike.</p> <p><i>Vizita ne IAL</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në ambientet e IAL-së, GVJ konstaton se Institucioni ofron mjediset të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Institucioni garanton, kapacitetet infrastrukurore në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (marrëveshje të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe internship-eve.</p> <p><i>Vizita ne IAL</i></p> <p>1. Siperfaqet POLIS.pdf</p> <p>2. Planimetri kati 0.pdf</p> <p>3. Planimetri kati 1.pdf</p> <p>5. Planimetri kati 3.pdf</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se U_POLIS ka mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit të mësimdhënies. Në dispozicion të studentëve janë auditorë dhe laboratorë modern në përmbushje të kërkesave të programit të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB, GVJ konstaton se çdo lektor i vendos studentëve në dispozicion syllabusin e lëndës në të cilin ndodhet literatura bazë dhe ndihmëse. [Aneks 27 Syllabuse.pdf] Literatura e cila ofrohet në format elektronik ose të printuar, mund të përdoret nga studentët për të marrë njohuritë në kurset e programit që ato ndjekin. Materialet në formë elektronike gjenden në klasat virtuale të krijuar në platformën google classroom. Gjithashtu U_POLIS disponon një bibliotekë në të cilën të gjithë studentët mund të aksesojnë literaturën e sugjeruar [Aneks 29.2 Literatura e CS ne PDF.pdf]. Referuar syllabus-eve të paraqitura si evidenca, verëhet një literaturë në përputhje me përmbajtjen e kursit, e cila ofrohet në shqip dhe anglisht, por <i>GVJ rekomandon që të azhurnohet literatura brenda 5 viteve të fundit.</i></p> <p>Aneks 27 Syllabuse.pdf</p> <p>Aneks 29.2 Literatura e CS ne PDF.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ konstaton se çdo fillim viti akademik, përgjegjësi i njësive bazë dhe kordinatori i programit të studimit në bashkëpunim me pedagogët e lëndës sugjerojnë dhe përditësojnë syllabuset e lëndëve. Gjithashtu ata angazhohen për shtimin e literaturës në gjuhë të huaj dhe shqip, bazuar në kërkesat që bëhen nga titullarët e kurseve.</p> <p>RVB MSc.Shkenca Kompjuterike_al.pdf</p> <p>Aneks 29.1 Format Activity Information Sheet 2023.pdf</p> <p>Aneks 29.2 Literatura e CS ne PDF.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të</p>	<p>Tek U_POLIS, ka një bibliotekë mësimore 155m², e cila i krijon mundësi studenteve të aksesojnë fizikisht dhe online materialet dhe tutorialet e nevojshme. Literaturat në bibliotekë shtohen sipas kërkesave të departamenteve, të cilët pasqyrojnë kërkesat e stafit akademik. Biblioteka ofron poste fizike, PC, akses në</p>




<p>barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>internet, në shërbim të studentëve. Më tepër informacion për bibliotekën gjendet https://universitetipolis.edu.al/biblio_polis/RVB_MSc.Shkenca_Kompjuterike_al.pdf</p> <p>Aneks 29.2 Literatura e CS ne PDF.pdf</p> <p>Aneks 30 Tabelat permbledhese per Aneks RVB SHK_01.pdf, Tabela 17</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në vizitën në IAL, u verifikua që U_POLIS, ofron një bibliotekë fizike dhe online. Biblioteka është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore në gjuhën shqipe dhe të huaj, libra dhe revista shkencore. Biblioteka ofron rreth 11065 tituj librash fizik, ku nje përqindje relativisht te vogël zënë botimet shqip në mbështetje të programit të studimit.</p> <p>Biblioteka azhuron tekstet bazuar në kërkesat e departamentit, programve të studimit, dhe donacioneve të huaja (siç janë projektet TEMPUS & Erasmus+).</p> <p>Aneks 29.1 Format Activity Information Sheet 2023.pdf</p> <p>Aneks 29.2 Literatura e CS ne PDF.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>U_POLIS, ofron një bibliotekë fizike dhe online. Bibliotekat online ku mund të aksesojë POLIS janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Biblioteka elektronike EBSCO ✓ Biblioteka elektronike JSTOR <p>Këto hapësira ofrojnë materiale te aksesueshme, pa pagesë për studentët dhe për stafin, I cili bazohet për realizimin e leksioneve. Aty mund të gjejnë mbi 90000 tituj librash elektronikë dhe mbi 600 tituj revistash, në referencë me fushat dhe programet e studimit që ofron U_POLIS.</p> <p>https://ulibrary.rash.al</p> <p>https://www.jstor.org</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në POLIS, GJV konstaton se në bibliotekë ka PC, me software-t e nevojshëm, të lidhur në internet për të mundësuar një përdorim sa më eficient të burimeve që biblioteka ka apo ofron. Biblioteka ofron poste</p>

	<p>fizike, PC, akses ne internet, të pajisur me programe aplikative në ndihmë të studentëve dhe detyrave që ata kanë.</p> <p><i>Vizita ne IAL</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka është në dispozicion të studentëve në orare zyrtare 8.00-16.00, dhe jo vetëm, ajo ofron shërbimin edhe në fundjave. Këto orare në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor, janë në përgjigje edhe të nevojave të studentëve. Procesi mësimor për programin e studimit Master I Shkencave 'Shkenca Kompjuterike', zhvillohet mbasdite, kështuqë studentët mund të aksesojnë këtë shërbim.</p> <p>RVB_MSc.Shkenca Kompjuterike_al.pdf</p> <p><i>Vizita ne IAL</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit të studimit master i shkencave, "Shkenca Kompjuterike", çdo fillim viti akademik zhvillojnë procedurën për pasurimin e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online përmes një kërkesë të departamentit bazuar në kërkesat e stafit. Përmes mail-it njësitë përgjegjëse e bibliotekës njofton njësitë përkatëse, stafin akademik dhe studentët për titujt e ri të ngarkuar në bibliotekë.</p> <p>Njësitë mban raporte dhe evidenca për përdoruesit, përmes një sistemi gjurmimi elektronik dhe fizik.</p> <p>RVB_MSc.Shkenca Kompjuterike_al.pdf</p> <p>Aneks 29.1 _Format _Activity Information Sheet 2023.pdf</p> <p>Aneks 29.2 _Literatura e CS ne PDF.pdf</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se çdo lektor i vendos studentëve në dispozicion syllabusin e lëndës në të cilin ndodhet literatura bazë dhe ndihmëse. Literatura e cila ofrohet në format elektronik ose të printuar, mund të përdoren nga studentët për të marrë njohuritë</i></p>

	<p><i>në kurset e programit që ato ndjekin. Materialet në formë elektronike gjëndën në klasat virtuale të krijuar në platformën google classroom. U_POLIS disponon një bibliotekë në të cilën të gjithë studentët mund të aksesojnë literaturën e sugjeruar. <u>GVJ rekomandon</u> të pasurohet literatura brenda 5 viteve të fundit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>U_POLIS disponon një sistem të menaxhimit PITAGORA, [Aneks 19 Manualet e Perdorimit PITAGORA.pdf] nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët. Ky sistem përdoret që nga viti 2019. Që në momentin e regjistrimit, studentët pajisen me kredencialet përkatëse për t'u log-uar ne system, ku marrin informacionin e nevojshëm në lidhje me arritjet e tyre akademike. Ky sistem shërben si urë komunikimi ndërmjet stafit dhe studentëve, ku përveç vlerësimit, marrin informacion rreth kurrikulës, kurseve, syllabuseve etj.</p> <p>RVB_MSc.Shkenca_Kompjuterike_al.pdf</p> <p>Aneks 19_Manualet e Perdorimit PITAGORA.pdf</p> <p>Aneks 14_Guida e Stafit_al.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit PITAGORA, [Aneks 19 Manualet e Perdorimit PITAGORA.pdf] administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit PAE/PAK, personelit ndihmës akademik, dhe zyrave përkatëse, siç është psh. Sekretaria, të angazhuar në realizimin e programit. Sistemi i menaxhimit PITAGORA siguron akses në informacione e dokumente për të gjithë personelin PAE/PAK dhe studentët e programit të studimit. Çdo zyrë akademike dhe</p>


<p>partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>administrative ka kredencialet e saj, si zyra e finances, juridike, burimet njerëzore, sekretaria etj. Përmes këtij sistemi, studentët plotësojnë në mënyrë anonime formularët e vlerësimit për stafin akademik</p> <p>RVB_MSc.Shkenca Kompjuterike_al.pdf</p> <p>Aneks 19 Manualet e Perdorimit PITAGORA.pdf</p> <p>Aneks 14 Guida e Stafit_al.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit PITAGORA siguron akses në informacione e dokumente për të gjithë personelin PAE/PAK dhe studentët e programit të studimit, duke krijuar kështu dosjen për secilin anëtar të stafit. Gjithashtu në system krijohen lidhje paralele ndërmjet sekretarisë, lektorëve dhe fakultetit ku bëjnë pjesë.</p> <p>RVB_MSc.Shkenca Kompjuterike_al.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit ka një shtrirje dhe organizim vertikal, ku çdo njësi akseson përmes kredencialeve përkatëse, Studentët aksesojnë syllabuset, vlerësimet etj., stafi akseson statusin e studentëve, vlerësimet, sekretaria akseson në vlerësimet e studentëve, regjistrat, rezultatet etj. Zyra juridike proceson kontratat e studentëve dhe stafit PAE/PAK.</p> <p>RVB_MSc.Shkenca Kompjuterike_al.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit PITAGORA, monitoron aktivitetin akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale. Çdo semester studentët plotësojnë përmes këtij sistemi pyetësorët për vlerësimin e stafit PAE/PAK. Përmes sistemit krijohet një koordinim i shpejtë dhe efektiv ndërmjet njësive akademike dhe atyre administrative.</p> <p>RVB_MSc.Shkenca Kompjuterike_al.pdf</p> <p>Vizita ne IAL</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Informacionet që lidhen me programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike", personelin akademik dhe aktivitete të ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, gjuha shqipe dhe gjuha angleze.</p> <p>RVB_MSc.Shkenca Kompjuterike_al.pdf</p> <p>Master of Science in Computer Science – Universiteti Polis</p>

Konkluzione	<p><i>U_POLIS disponon një sistem të menaxhimit PITAGORA, nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me stafin dhe studentët. E gjithë procedura akademike dhe administrative realizohet përmes këtij sistemi.</i></p> <p><i>Sistemi i menaxhimit PITAGORA siguron akses për të gjithë personelin PAE/PAK dhe studentët e programit të studimit. Çdo zyrë akademike dhe administrative ka kredencialet e saj, si zyra e finances, juridike, burimet njerëzore, sekretaria etj.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në POLIS, GVJ konstaton se në fillim të çdo viti akademik, rektorati depoziton raporte pranë fakulteteve të njësisë bazë dhe njësisë administrative të tjera të universitetit për të mbledhur informacion mbi nevojat e tyre specifike. Pasi formularët plotësohen ato i kthehen rektoratit e më pas prej rektoratit merren vendime bazuar në planin strategjik [Aneks 2 Strategjia e Zhvillimit 2021-2026.pdf] të U_POLIS dhe Statutin [Aneks 1 Statuti i Universitetit POLIS.pdf, Neni 54, 55] dhe rregulloren e POLIS. Propozimet miratohen nga Bordi i Administrimit. Në fillim të çdo viti akademik hartohet buxheti, i cili pasqyron shpenzimet bazuar në kërkesat e departamenteve dhe të ardhurat e IAL-së.</p> <p>RVB_MSc.Shkenca_Kompjuterike_al.pdf</p> <p>Aneks 2 Strategjia e Zhvillimit 2021-2026.pdf</p> <p>Aneks 1 Statuti i Universitetit POLIS.pdf</p> <p>Aneks 48 Raporti Vjetor 2022-2023.pdf</p>




<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës shkencore.</p>	<p>GVJ konstaton se universiteti POLIS fondet parësore i ka nga tarifat e studenteve, fondet e tjera përfshijnë projektet kërkimore ndërkombëtare dhe fonde të tjera kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare. Shpenzimet janë të ndara sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 79% shpenzime paga PAE/PAK, lektorë të ftuar; • 16% shpenzime didaktike dhe administrative; • 5% shpenzime per laboratore; <p>Aneks 48_Raporti Vjetor 2022-2023.pdf</p> <p>Aneks _____ 30 Tabelat _____ permbledhese _____ per</p> <p>Aneks_RVB_SHK_01.pdf, Tabela 18</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se pasqyrat financiare auditohen nga nje kompani e huaj auditimi. Cdo vit raporti i pasqyrave financiare i nënshtrohet kontrollit sipas standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilizimit. Institucioni kryen auditime të përvitshme, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Të ardhurat për këtë program studimi bazohen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ 86% nga tarifat e studentëve; ✓ 14% sufiçiti i programeve të tjera, projekte Erasmus+ dhe AKSHI; <p>Aneks _____ 30 Tabelat _____ permbledhese _____ per</p> <p>Aneks_RVB_SHK_01.pdf, Tabela 18</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Në U_POLIS zbatohet strategjia e diversifikimit të burimeve të të ardhurave. U_POLIS ka krijuar një portofol që shkon përtej aktivitetit akademik, ku përfshihen projekte, grante, konferenca, konsulenca, lidhje me biznesin, për të rritur të ardhurat dhe ulur riskun e rënies së tyre. Ky plan strategjik i paraprin riskut në lidhje me rënien e nurnit të studentëve.</p> <p>Aneks 48_Raporti Vjetor 2022-2023.pdf</p> <p>Aneks _____ 30 Tabelat _____ permbledhese _____ per</p> <p>Aneks_RVB_SHK_01.pdf, Tabela 18</p>




<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>U_POLIS në fillim të çdo viti harton buxhetin vjetor dhe një parashikim 3-5 vjeçar të vetë institucionit dhe programit të studimit, që të kuptojë dhe planifikojë nevojat.</p> <p>Polis ka hartuar dhe zbaton një strategji të qëndrueshme financiaree cila konsiston ne 3 shtylla kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Ruajtja dhe përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe krkimit shkencor ✓ Efikasiteti dhe optimizimi i burimeve njerëzore, infrastrukturës përmes modelit “Eknomia e qëllimit” dhe dixhitalizimi i proceseve. ✓ Diversifikimi i programeve të studimit për të krijuar një portofol për uljen e riskut nga rënia e nurmit të studentëve, apo përtej aktivitetit akademik, si trajnime, kualifikime, konsulenca etj. <p>RVB_MSc.Shkenca Kompjuterike_al.pdf</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se U_POLIS ka qëndrueshmëri dhe mirëorganizim të të ardhurave. Çdo fillim viti hartohen pasqyrat financiare, ku përfshihen kërkesat dhe nevojat e njësisë bazë dhe programit të studimit. Të ardhurat për këtë program studimi bazohen në 86% nga tarifat e studentëve dhe 14% sufiçiti i programeve të tjera, projekte Erasmus+ dhe AKSHI</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>RVJ konstatoi se U_POLIS, afishon çdo vit programet e akredituara. Procedurat dhe kriteret janë të përcaktuara në rregulloren didaktike [Aneks 4 Rregullore Didaktike.pdf, Neni 9, 10, 11] dhe rregulloren e programit [Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf, Neni 8].</p> <p>Deri më sot, në këtë program studimi, Master i shkencave ‘Shkenca Kompjuterike’, nuk ka patur raste studentësh të transferuar.</p> <p>Aneks 4 Rregullore Didaktike.pdf</p> <p>Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf</p> <p>Vendim per kriteret e pranimit.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit Master i shkencave ‘Shkenca Kompjuterike’ mund të ndiqet nga çdo shtetas shqiptar, etnitë jashtë kufijve shtetërore si dhe cdo shtetas i huaj, në bazë të legjislacionit në fuqi.</p> <p>U_POLIS krijon mundësi komunikimi me ambientin e jashtëm nëpërmjet ëeb-it zyrtar (http://universitetipolis.edu.al), ditëve të informimit, etj. ZMSKK është një njësi që ndjek studentët gjate kohës së studimeve dhe përtej.[Aneks 35 Rregullore ZMSKK.pdf] Kjo zyrë ofron transparencë në lidhje me procedurat dhe çështjet akademike, mësimore, shkencore, gjithashtu qas studentët në tregun e punës.</p> <p>Aneks 1 Statuti i Universitetit POLIS.pdf</p> <p>Aneks 5 Rregullore FKZH.pdf</p> <p>Aneks 35 Rregullore ZMSKK.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore,</p>	<p>GVJ konstaton se çdo vit akademik, referuar urdhërit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për regjistrimet dhe transferimet, publikon në ueb-in dhe rrjetet sociale të U_POLIS informacion lidhur me programet e studimit dhe kriteret përkatëse. Propozimi bëhet nga departamenti përgjegjës për programin e studimit, miratim nga fakulteti përkatës dhe vendimi merret nga senati akademik, për kriteret e pranimit dhe kuotat e kandidatëve.</p>




sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	<p>Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf, Neni 9, 10</p> <p>Aneks 33 Politika e marketigut - Polis@Glance.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ konstatoi se kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, vlerësimet gjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të aksesueshme përmes faqes ëeb dhe rrjeteve sociale që U_POLIS menaxhon. Gjithashtu në U_POLIS ndodhet zyra e Pranimeve dhe Informacionit, që ndihmon të interesuarit. Në këtë program nuk ka student të transferuar.</p> <p>Aneks 1 Statuti i Universitetit POLIS.pdf, Neni 48</p> <p>Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf, Neni 13</p> <p>Ueb: Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike – Universiteti Polis</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga vizita në IAL dhe evidencat se përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. Këto kriteret bëhen publike në në faqen ueb të U-POLIS. Gjithashtu zhvillohen ditët e hapura, ku maturantët mund të vizitojnë ambientet e U_POLIS.</p> <p>Aneks 1 Statuti i Universitetit POLIS.pdf, Neni 48</p> <p>Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf, Neni 13</p> <p>Ueb: Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike – Universiteti Polis</p> <p>Vendim per kriteret e pranimit.pdf</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p> <p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti</p>	<p>GVJ konstatoi nga vizita në IAL dhe evidencat se përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit [Vendim per kriteret e pranimit.pdf], në përputhshmëri me Ligjin 80/2015 dhe Urdhërit përkaës të përvitshëm të MAS për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe kandidatëve nga shtete të tjera. U_POLIS është pjesë e projektit IDEA</p>

akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	(Inclusive tertiary Education in the Western Balkans) dedikuar integritit të studentëve me aftësi ndryshe. Aneks 41_Kurs Katalogu Programi al_en_draft.pdf			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ konstatoi nga vizita në IAL se U_POLIS ka përcaktuar politika të ndihmës/bursave për shtresat në nevojë bazuar në Ligjin 80/2015 dhe Urdhërit përkaës të përvitshëm të MAS, Neni 65 të statutit. Gjithashtu me mbështetjen e “Bordi i themeluesve”, sipas nje procedure të mirëpërcaktuar me ligj, bazuar në misionin social të U_POLIS, ofron tarifa të reduktuara për studentët në nevojë. Aneks I Statuti i Universitetit POLIS.pdf,Neni 65 UEB: Bursa Studimi – Universiteti Polis			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se Universiteti Polis harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit Master i shkencave “Shkenca Kompjuterike të Aplikuara”. Universiteti përdor faqen zyrtare të uebit, rrjetet sociale si mjet komunikimi gjithëpërfshirës. Universiteti POLIS ofron mundësinë e regjitrimit në këtë program, studentëve shqiptarë, të huaj etj. Universiteti ofron bursa për studentët me arritje të larta dhe bursa sociale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit	GVJ konstatoi nga vizita në IAL dhe RVB e dorëzuar në system se U_POLIS ka një system të organizuar për menaxhimin e informacionit. IAL vë në dispozicion një informacion të plotë në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të

<p>akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion publikohet në disa mënyra:</p> <ul style="list-style-type: none"> • në format elektronik, përmes faqes ueb dhe ne llogarinë personale të studentit, në sistemin PITAGORA; • në formë të shkruar, brenda mjediseve të U_POLIS; <p>Informacioni për mënyrën e vlerësimit, u dërgohet studentëve përmes mail-it, ose përmes rregullores didaktike. Koordinatori i programit të studimit ndjek studentët dhe koordinon procesin akademik brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Aneks 4 Rregullore Didaktike.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Në programin e studimit master i shkencave “Shkenca Kompjuterike”, nuk ka patur raste transferimi të studentëve. Megjithatë procedura është e paraqitur qartë në rregulloren didaktike dhe rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Aneks 4 Rregullore Didaktike.pdf</p> <p>Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf,Neni 12</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar ne dokumentacionin e ofruar nga IAL-ja dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi që institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve të studentëve në programin e studimit. Në orën e parë të mësimit bëhet prezantimi i programit të lëndës dhe vlerësimit përkatës.</p> <p>Aneks 27 Syllabuse.pdf</p> <p>Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf,Neni 14</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi që institucioni informon studentët në lidhje me procedurat e diplomimit të studentëve në programin e studimit master i shkencave “Shkenca Kompjuterike”, në vitin e dytë të studimeve. U_POLIS ka hartuar një rregullore, “Rregullore Diplomimi”, ku tregohet plani i detajuar i procesit të diplomimit.</p> <p>Aneks 4 Rregullore Didaktike.pdf</p> <p>Aneks 6 Rregullore Programi Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf,Neni 14</p> <p>Aneks 7 Rregullore Diplome Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf</p>

<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>U_POLIS përdor mjete të ndryshme informimi, përmes publikimit të informacionit në rrjetet sociale që ai menaxhon, ambientet e IAL-së, fletëpalosje dhe broshura, të cilat japin informacion rreth përshkrimit të programit të studimit, objektivat, kriteret, mundësitë e punësimit, kurrikulën etj.</p> <p>Aneks 55.2_Kalendari i aktiviteteve FKZH_22-23.pdf</p> <p>Aneks 55.1_Kalendari i aktiviteteve FKZH_23-24.pdf</p> <p>https://ëëë.instagram.com/polisuniversity/?hl=en</p> <p>https://ëëë.facebook.com/polisuniversity/</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se U_POLIS përdor mjete të ndryshme informimi, përmes publikimit të informacionit në rrjetet sociale që ai menaxhon, ambientet e IAL-së, fletëpalosje dhe broshura. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve të studentëve në programin e studimit dhe procesin e diplomimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar për kurrikulën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe fletëpalosje/ udhëzues për lëndët/modulet, kurrikulën dhe veprimtaritë formuese. Ky informacion gjendet në rregulloren e programit të studimit, didaktike, diplomimit dhe guidën e studentit. Gjithashtu studentët mund të aksesojnë edhe nëpërmjet sistemit për tu njohur me kurrikulën dhe syllabuset.</p> <p>Aneks 4_Rregullore Didaktike.pdf</p> <p>Aneks 6_Rregullore Programi_Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet,</p>	




përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Aneks 7 Rregullore Diplome Msc. Shkenca Kompjuterike.pdf Aneks 34 Guida e Studentit.pdf			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	U_POLIS ka struktura të mirëpërcaktuara në mbështetje të studentëve. Në strukturën e POLIS, ka një zyrë përgjegjëse për orientimin dhe informimin e studentëve, kjo zyrë është ZMSKK (Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillim Karriere). Gjithashtu POLIS është pjesë e platformës GRADUA (https://gradua.rash.al) e cila synon të mbështesë universitetet dhe studentët në tregun e punësimit. POLIS ka bashkëpunime të shumta në ndihmë të studentëve të degës Master i shkencave “Shkenca Kompjuterike”.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentët e degës Master i shkencave “Shkenca Kompjuterike” njihen me orarin që në fillim të semestrit. Nëse do ketë ndryshime, studentët njoftohen përmes sekretarisë mësimore ose me mail. Në POLIS zhvillohen ditët e orientimit, ku studentët njihen me ambientet dhe personelin përgjegjës për menaxhimin e tyre. Ky informacion mund të gjendet edhe në faqen ueb http://www.universitetipolis.edu.al/			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni në lidhje me programin e studimit paraqitet në systemin e menaxhimit PITAGORA, i cili është lehtësisht i arritshëm nga studentët kudo ata ndodhen. Gjithashtu studentët mund të aksesojnë edhe nëpërmjet sistemit për tu njohur me kurrikulën dhe syllabuset Studentët marrin informacion rreth performancës dhe arritjeve të tyre akademike. Aneks 19 Manualet e Perdorimit PITAGORA.pdf			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se U_POLIS ka struktura të mirëpërcaktuara në mbështetje të studentëve. Në POLIS zhvillohen ditët e orientimit, ku studentët njihen me ambientet dhe personelin përgjegjës për menaxhimin e tyre. Studentët informohen në mënyrë të detajuar për kurrikulën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se U_POLIS mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit Master Shkencor ‘Shkenca Kompjuterike’. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, transferimet nga program dhe largimet. POLIS ka një sistem të organizuar për këtë program. Studentët informohen në fillim të çdo viti për mënyrën organizimit të kurseve, kreditet, vlerësimin përmes syllabusit të kursit. Informacioni ruhet në format elektronik dhe hard-copy, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Regjistri i procesit mësimor; • Regjistri i notave; • Regjistri bazë; • Regjistri i diplomave; <p>Ky program është në vitin e dytë të zbatimit, kështuqë nuk ka akoma student të diplomuar. Koordinator I programit të studimit, ka një rol nërmjetës në menaxhimin e këtij informacioni.</p> <p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është si më poshtë vijon:</p> <p>Viti akademik 2022-2023 18 studentë;</p> <p>Viti akademik 2023-2024 36 studentë;</p> <p><u>Aneks 30 Tabelat permbledhese per</u> <u>Aneks_RVB_SHK_01.pdf, tabela 23</u></p> <p><u>Aneks 31 Vendim per emerimin e koordinatorit e programeve</u> <u>23-24_REV.pdf</u></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes</p>	<p>Informacioni statistikor në lidhje me programin e studimit ruhet në sistemin e menaxhimit PITAGORA. Ky system lejon ruajtjen e të dhënave në mënyrë të sigurtë dhe gjenerimin automatic të</p>

<p>sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>statistikave. Në fillim të vitit akademik çdo student nënshkruan një deklaratë ku autorizon universitetin Polis për përdorimin e të dhënave për qëllime statistikore.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>GVJ konstatoi që institucioni zhvillon kontrole periodike pranë gjithë njësive përgjegjëse si fakultetet, departamentet, sekretaritë mësimore, njësitë administrative, etj ku vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët dhe programet e studimit. Grupi ad-hoc shkruan një raport analitik, ku analizohen të dhënat dhe përmirësimet e nevojshme për rritjen e cilësisë.</p> <p>Aneks 48 Raporti Vjetor 2022-2023.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Në fund të çdo viti akademik, njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, përqindjen e cilësisë së punësimit të tyre. Dekanati është përgjegjës për analizimin e tyre. ZMSKK është përgjegjëse për monitorimin dhe gjurmimin e studentëve pas diplomimit. Ky informacion duhet të paraqitet në raportin vjetor të IAL-ës. Në këtë program studimi nuk ka akoma student të diplomuar.</p> <p>Aneks 30 Tabelat permbledhese per Aneks_RVB_SHK_01.pdf</p> <p>Aneks 48 Raporti Vjetor 2022-2023.pdf</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se U POLIS mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit Master i Shkencave 'Shkenca Kompjuterike'. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, transferimet nga program dhe largimet. POLIS ka një system të organizuar për këtë program. Në këtë program studimi nuk ka akoma student të diplomuar.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>U_POLIS parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore në fuqi. Në përputhje me ligjin Nr. 80/2015 dhe statutin e universitetit, studentët janë të përfaqësuar në organe vendimmarrëse, si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Senati akademik; 2. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC); 3. Këshilli studentor; <p>Studenti ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet në përfaqësinë studentore. Senati studentor është pjesë e strukturës së universitetit Polis. https://universitetipolis.edu.al/senati-studentor-2/</p> <p>Aneks 1 Statuti i Universitetit POLIS.pdf</p> <p>https://universitetipolis.edu.al/senati-studentor-2/</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Senati studentor është pjesë e strukturës së universitetit Polis, I cili në bashkëpunim me organet drejtuese të U_POLIS, ushtron veprimtarinë e tij. Rektori dhe dekani nuk zgjidhen me votë, ata emërohen nga instancat përkatëse. Studentët kanë përfaqësi në: Senati akademik, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC), Këshilli studentor. Studentët përfshihen përmes opinionit të tyre në hartimin e raportit vjetor. Senatori mban lidhje të vazhdueshme me koordinatorin e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e</p>	<p>GVJ konstatoi se njësitë përgjegjëse, dekanati, koordinatori, në fund të çdo semestri zhvillojnë takime me studentët e programit <i>Master i Shkencave</i> në ‘Shkenca Kompjuterike’, me qëllim të</p>

hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	diskutojnë performancën, kushtet laboratorike, nevojat dhe pritshmëritë, rishikimi i sugjerimeve për syllabuset dhe kurrikulën. U_POLIS zbaton metoda analitike për të përcaktuar mendimin e studentëve.			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentët master i shkencave ‘Shkenca Kompjuterike’, shprehin mendimin e tyre përmes plotësimit të pyetësorëve për vlerësimin e lektorëve në formë anonime. Rezultatet analizohen dhe menaxhohen nga NJSBC. U_POLIS ka rregulloren didaktike, e cila jep informacionin e plotë mbi procedurën e vlerësimit. Nëse student ka pakënaqësi, ai mund të bëjë një ankimim, të cilin ja drejton dekanit. Dekani shqyrton kërkesën, dhe vendos nëse do e pranojë ose jo.			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se studentët janë të përfaqësuar në U_POLIS. Ata përfaqësohen në senatin akademik dhe NJSBC. Sugjerimet e tyre merren në konsideratë nga koordinatori i programit të studimit dhe përgjegjësi i departamentit. U_POLIS ka rregulloren didaktike, e cila jep informacionin e plotë mbi procedurën e vlerësimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>U_POLIS në strukturën e tij ka ZMSKK (Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillim Karriere), me qëllim informimin dhe mbështetjen e studentëve, për procesin mësimor, praktikat profesionale, gjetjen e punës pas diplomimit etj. Koordinator i programit të studimit është më afër studentëve, duke i dhënë informaciontë vazhdueshëm rreth procedurave, këshillimit etj.</p> <p>Aneks 35 Rregullore ZMSKK.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka ngritur një sistem për informimin, këshillimin, ndjekjen e studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Njësitë përgjegjëse për këshillim dhe ndjekje të studentëve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Strukturat përgjegjëse, si fakulteti, departamenti etj; • Koordinator i programit të studimit; • ZMSKK; <p>Ky system ndjek studentët nga regjistrimi deri në njohjen me tregun e punës.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>POLIS u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Njësia për këshillimin e karrierës, ZMSKK, mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim në lidhje me procesin mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale dhe tregun e punës.</p> <p>Studentët aktualë të këtij programi studimi do të informohen dhe këshillohen përgjatë vitit akademik 23-24.</p> <p>Gjithashtu departamenti i Kërkimit Shkencor, organizon çdo vit panairin e punës, ku mund të krijohet lidhja direkte e studentit me tregun e punës.</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua</p>	<p>Zyra e karrierës ndjek studentët pas diplomimit. Kjo zyrë përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike. ZMSKK realizon orientimin profesional, këshillimin individual ose në grup, gjithashtu bashkëpunon me shoqatën Studentore dhe Alumni.</p>





vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.				
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se POLIS u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Njësia për këshillimin e karrierës, ZMSKK, mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim në lidhje me procesin mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale dhe tregun e punës. ZMSKK realizon orientimin profesional, këshillimin individual ose në grup, gjithashtu bashkëpunon me shoqatën Studentore dhe Alumni.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore institucioni i arsimit të lartë përmbush të gjitha detyrimet dhe ka krijuar të gjithë mjetet për menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë së brendshme. Institucioni ka zhvilluar rregulloren e vet bazuar në kuadrin ligjor i cili është si vijon: - Ligjin Nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, neni 103,104, 106 dhe 46;

	<ul style="list-style-type: none"> - Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, miratuar me VKM Nr.531, date 11.9.2018; - Standardet dhe Udhëzimet Europiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (SUE); - Statutin e Universitetit “POLIS”; - Rregulloren e Universitetit “POLIS”; - Manualin e ASCAL për Sistemin e Brendshëm të Cilësisë; <p>NJSBC në shërbim të përmirësimit të cilësisë, zbaton dhe menaxhon të dhënat në një frekuence periodike, çdo semestër sa i përket procesit të mësimdhënies, dhe çdo vit sa i përket proceseve administrative dhe përmbajtjes kurrikulare.</p> <p>Aneks 2 Strategjia e Zhvillimit 2021-2026.pdf</p> <p>Aneks 4 Rregullore Didaktike.pdf</p> <p>Aneks 8 Rregullore NJBSC.pdf</p> <p>Aneks 51 Internal Quality Assurance Strategy 2023-2027.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL, vërehet se në U_POLIS ka një njësi të qëndrueshme, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë. Kjo njësi bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet, dhe menaxhon procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike, bazuar në strategjinë e zhvillimi institucional.</p> <p>Aneks 17.1 Vleresimi i kolegut per kolegun.pdf</p> <p>Aneks 17.3 Vetevleresim i performances se lektorit.pdf</p> <p>Aneks 17.4 Pyetesor per vleresimin e pedagogut nga studentet.pdf</p> <p>Aneks 17.2 Formular per vleresimin.pdf</p> <p>Aneks 17.5 Formular per vleresimin e proceseve administrative.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve,</p>	<p>U_POLIS ofron metoda për vlerësimin periodik të metodave të mësimdhënies dhe kontrollin e njohurive. Në fund të çdo semestri, studentët japin mendimet e tyre përmes nje pyetësori [Aneks 17.2 Formular per vleresimin.pdf]. Studentët në mënyrë anonime shprehin mendimin e tyre për lektorët e lëndëve që ndjekin përmes pyetjeve me qarkim, gjithashtu kanë një hapësirë ku mund të shprehin mendimin apo sugjerimin e tyre [Aneks</p>




<p>përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>17.4 Pyetesor per vleresimin e pedagogut nga studentet.pdf]. Ky pyetesor plotësohet në format elektronik përmes sistemit PITAGORA. Studentët kanë hapësirë të shprehin pakënaqësitë e tyre, në lidhje me vlerësimin, performancën mësimore, literaturën etj.</p> <p>Aneks 4 Rregullore Didaktike.pdf Neni 58</p> <p>Aneks 3 Rregullore Pergjithshme.pdf neni 82</p> <p>Aneks 17.2 Formular per vleresimin.pdf</p> <p>Aneks 17.4 Pyetesor per vleresimin e pedagogut nga studentet.pdf</p> <p>Aneks 17.5 Formular per vleresimin e proceseve administrative.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike. Rezultatet e gjeneruara nga pyetesorët paraqiten në raport vjetor që kjo njësi përpunon. Gjithashtu rezultatet i dërgohen njësive drejtuese, duke ofruar transparencë në menaxhimin e tyre. Gjithashtu, në POLIS, mbledhjet e senatit organizohen si mbledhje të hapura, ku marrin pjesë staf dhe studentë.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>U_POLIS nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra nga pyetesorët, afishon rezultatet në raportin vjetor, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Gjithashtu në U_POLIS realizohet vlerësim i stafit kundrejt njëri-tjetrit [Aneks 17.1 Vleresimi i kolegut per kolegun.pdf] dhe në fund të çdo viti secili anëtar i stafit akademik plotëson formularin e vetëvlerësimit [Aneks 17.3 Vetevleresim i performances se lektorit.pdf]. Në raport paraqiten rezultatet e pyetesorëve që u përmendën në më lart në kriterin 3, vlerësim i stafit kundrejt njëri-tjetrit dhe rezultatet e vetëvlerësimit, të gjitha këto përfshihen në raportin e pikësimit [Aneks 23 Sistemi i pikësimit.pdf]. NJSBC dërgon në senat raportin, i cili diskutohet dhe shpërndalet në instancat përkatëse. Dekani dhe përgjegjësi i departamentin, trajtojnë rastet sipas specifikave, duke përmirësuar metodat e mësimdhënies.</p> <p>Aneks 17.1 Vleresimi i kolegut per kolegun.pdf</p>




	Aneks 17.3_Vetevleresim i performances se lektorit.pdf Aneks 22_Raport Vjetor kerkimi shkencor 22-23.pdf Aneks 23_Sistemi i pikësimit.pdf Aneks 32_Raporti Vjetor NJBSC 2022-2023.pdf			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstatoi se U_POLIS ofron metoda për vlerësimin periodik të metodave të mësimdhënies dhe kontrollin e njohurive. Në fund të çdo semestri, studentët japin mendimet e tyre përmes një pyetësi. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike. Rezultatet e gjeneruara nga pyetesorët paraqiten në raport vjetor që kjo njësi përpunon.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>U_POLIS në përputhje me ligjin Nr. 80/2015 dhe statutin e universitetit, ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC). Në këtë IAL, ekziston Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, NJSBC, e cila bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike.</p> <p>Aneks 8_Rregullore NJBSC.pdf Aneks 51_Internal_Quality_Assurance_Strategy_2023-2027.pdf</p>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji	<p>Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, NJSBC, e cila bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike. Rezultatet e gjeneruara nga pyetesorët paraqiten në raport vjetor që kjo njësi</p>




<p>institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>përpunon. Kjo njësi është e përhershme dhe përbëhet nga 9 anëtarë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Drejtuesi është staf akademik i brendshëm; • ka përfaqësues nga studentët; • ka përfaqësues nga ALUMNI; • ka përfaqësues nga komuniteti i biznesit; <p>Kjo njësi është e angazhuar për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p> <p>Aneks 8 Rregullore NJBSC.pdf</p> <p>Aneks 32 Raporti Vjetor NJBSC 2022-2023.pdf</p> <p>Aneks 30 Tabelat përmbljedhese per Aneks_RVB_SHK_01.pdf, tabela 24</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>U_POLIS përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Ai përdor metodologji dhe teknika për vlerësimin e mësimdhënies, cilësisë së literaturës si dhe përbushjen e objektivave të programit të studimit. U_POLIS është pjesë e projekteve ndërkombëtare, si QainAL “Mbështetja strategjike për forcimin e strukturave të sigurimit të cilësisë në institucionet private të arsimit lartë” (http://www.qainal.eu/page.aspx?id=1.2).</p> <p>Procesi për përmirësimin e cilësisë është i rregulluar nëpërmjet procedurave periodike të hartuara dhe të përshtatura me standartin ISO 9001:2015. Disa nga proceset e NJSBC janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies; • Vlerësimi i proceseve administrative; • Vlerësimi i performancës akademike; • Hartimi i raporteve individuale; • Hartimi i raportit vjetor; <p>Aneks 17.1 Vlerësimi i kolegut per kolegun.pdf</p> <p>Aneks 17.3 Vetëvlerësim i performances se lektorit.pdf</p> <p>Aneks 17.2 Formular per vlerësimin.pdf</p>
	<p>Aneks 17.4 Pyetesor per vlerësimin e pedagogut nga studentet.pdf</p>

	<p>Aneks 17.5_Formular per vleresimin e proceseve administrative.pdf</p> <p>Aneks 23_Sistemi i pikësimit.pdf</p> <p>Aneks 32_Raporti Vjetor NJBSC 2022-2023.pdf</p> <p>Aneks 48_Raporti Vjetor 2022-2023.pdf</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Njësia e sigurimit të cilësisë operon në nivel universiteti. Procesi për përmirësimin e cilësisë është i rregulluar përmes procedurave periodike të përshtatura me standartin ISO 9001:2015.</p> <p>Qëllimet e NJBSC evoluojnë rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Rritjes së vazhdueshme të cilësisë së drejtimit të U POLIS nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave bashkëkohore dhe institucionalizimit të praktikave më të mira. ✓ Zbatimi i programeve akademike që përkojnë me synimet që ka institucioni; ✓ Rritja e vazhdueshme e cilësisë së formimit të studentëve, ✓ Zhvillimi i një sistemi cilësie për të përmirësuar performancën akademike dhe administrative. <p>Të dhënat dhe gjetjet bëhen pjesë e raporteve të pjesshme dhe atyre vjetore të NJBSC-së si dhe Raportit Vjetor të Përgjithshëm Institucional (Aneks 48_Raporti Vjetor 2022-2023.pdf) që përgatitet në fund të çdo viti akademik. Ky raport i dërgohet MAS dhe ASCAL.</p> <p>RVB_MSc.Shkenca Kompjuterike_al.pdf</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se U POLIS përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Ai përdor metodologji dhe teknika për vlerësimin e mësimdhënies, cilësisë së literaturës si dhe përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, NJSBC, e cila bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>U_POLIS përdor metodologji vlerësimi sa i përket mbarëvajtjes së procesit të mësimdhënies, cilësisë pedagogjike dhe akademike. Në fund të çdo viti akademik, NJSBC përgatit një raport, të cilin e shpërndan në formë zyrtare në senat, pastaj rektorat, dekanat, department. Bazuar në të dhënat e raportit nxirren rezultate dhe rekomandime për përmirësimin e cilësisë dhe mësimdhënies. Rezultatet e pyetësorëve bëhen publik ndaj stafit, studentëve, administratës etj. Këto raporte dërgohen në MAS dhe ASCAL, dhe në bibliotekën e U_POLIS.</p> <p>Aneks 8_Rregullore NJSBC.pdf</p> <p>Aneks 32_Raporti Vjetor NJSBC 2022-2023.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Raportet e vlerësimit të cilësisë përfshijnë rezultatet e pyetësorëve të vlerësimit të cilat u përmendëm më lart (Standarti VI.3, Kriteri 1), dhe analizën krahasuese me rezultatet e një viti më parë. Bazuar në këto rezultate nxirren rekomandimet perkatëse. Këto rezultate i komunikohen stafit, studentëve, administratës dhe personave të interesuar.</p> <p>NJSBC harton raporte të pjesshme dhe raportin vjetor të përgjithshëm që përgatitet në fund të çdo viti akademik.</p> <p>Rezultatet e pyetësorëve bëhen publike, duke ja komunikuar stafit, studentëve, administratës dhe me gjerë, përmes mailit, raporteve, njoftimeve publike etj.</p> <p>RVB_MSc.Shkenca Kompjuterike_al.pdf</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>U_POLIS në këtë program studimi përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, vlerësimi i didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve. Procesi i vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies përbëhet nga 4 pjesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi nga studentët (50%); • Vlerësimi nga kolegët (35%); • Vetë-vlerësimi (15%); • Vlerësimi nga drejtuesit (process analizë); <p>Këto forma vlerësimi zhvillohen në mënyrë anonime, që të dhënat të jenë sa më reale.</p> <p>Ky vlerësim shërben si vlerësim përfundimtar për performancën e përgjithshme të secilit staf akademik, bashkangjitur edhe punën shkencore.</p> <p>Aneks 17.1_Vleresimi i kolegut per kolegun.pdf</p> <p>Aneks 17.2_Formular per vleresimin.pdf</p> <p>Aneks 17.3_Vetevleresim i performances se lektorit.pdf</p> <p>Aneks 17.4_Pyetesor per vleresimin e pedagogut nga studentet.pdf</p> <p>Aneks 17.5_Formular per vleresimin e proceseve administrative.pdf</p> <p>Aneks 23_Sistemi i pikësimit.pdf</p> <p>Aneks 20_Pyetesor Alumni.pdf</p> <p>Aneks 32_Raporti Vjetor NJBSC 2022-2023.pdf</p> <p>Aneks 48_Raporti Vjetor 2022-2023.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e</p>	<p>Gjithashtu U_POLIS ofron metoda të tërthorta vlerësimi, si stafi i ri këshillohet, orientohet dhe njihet me praktikat më të mira që të kenë një përmirsim të vazhdueshëm apo edhe sondazhet. Ato bëhen ndaj studentëve që ndjekin studimet, të diplomuarve (alumni), bizneseve etj. Personeli akademik në kontratën që firmos, njihet me të gjithë format e vlerësimit.</p> <p>Një tjetër sondazh i rëndësishëm në POLIS, janë edhe rezultatet që përcillen nga ASCAL, referuar Sondazhit Kombëtar të Studentëve. Këto rezultate merren në konsideratë në politikat e përmirësimit të cilësisë.</p>

<p>administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Aneks 23 Sistemi i pikësimit.pdf Aneks 20 Pyetesor Alumni.pdf Aneks 32 Raporti Vjetor NJBSC 2022-2023.pdf Aneks 48 Raporti Vjetor 2022-2023.pdf</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se U_POLIS përdor metodologji vlerësimi sa i përket mbarëvajtjes së procesit të mësimdhënies, cilësisë pedagogjike dhe akademike. Në fund të çdo viti akademik, NJSBC përgatit një raport, të cilin e shpërndan në formë zyrtare në senat, pastaj rektorat, dekanat, department. Raportet e vlerësimit të cilësisë përfshijnë rezultatet e pyetësorëve të vlerësimit, dhe analizën krahasuese me rezultatet e një viti më parë. Bazuar në këto rezultate nxirren rekomandimet perkatëse.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në U_POLIS, ka bashkëpunim ndërmjet fakulteteve dhe departamenteve, në ndihmë të ruajtjes së cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave “Shkenca Kompjuterike të Aplikuara”. FKZH bashkëpunon me instucione dhe kompani partnere për të përmirësuar përvojën e mësimdhënies në këtë fushë. NJSBC komunikon dhe bashkëpunon vazhdimisht me departamentin që ofron këtë program studimi.</p> <p>Rezultatet e përpunuara nga pyetësorët përfshihen në performancën akademike që drejtuesi i njësisë kryesore, përpilon në fund të çdo viti akademik me secalin anëtar të stafit.</p>




	Aneks 49_Raporti i vleresimit te departamentit per stafin akademik.pdf
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	<p>GVJ vëren se gjatë mbledhjeve të senatit, rektoratit, dekanatit në U_POLIS, përcakton qartë detyrat, dhe përshkallëzimi i tyre nga njësia kryesore, tek njësia bazë e deri në nivel lektorësh. Një sërë detyrash lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, si kontrolli i vazhdueshëm i kurrikulave, syllabuseve, organizimi i pjesëmarrjeve në orë leksionesh të hapura apo ftesa ndaj lektorëve të jashtëm me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Një rol me rëndësi ka koordinatori i programit të studimit, i cili shërben si urë lidhëse ndërmjet studentëve dhe njësisë së cilësisë. Çdo fillim viti akademik, departamenti mbledhet dhe diskuton për përmirësimin e kurrikulës dhe syllabuseve. Lektorët sugjerojnë literaturën mbështetëse.</p> <p>40.1 Plani mesimore_Msc_SHK.pdf</p> <p>40.4 Matrica MSC CS 2023-2024.pdf</p> <p>Aneks 30 Tabelat permblidhese per Aneks_RVB_SHK_01.pdf</p>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	<p>U_POLIS operon me procedura të sigurimit të cilësisë që demonstrojnë transparencë dhe përgjegjësi për të gjithë aktorët e saj. Të gjitha strukturat e institucionit sigurojnë një shërbim cilësor dhe nxisin rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet. I gjithë personeli akademik dhe administrativ ka një rol kyç në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm me NJSBC. Senati si organi më i lartë akademik ka përgjegjësinë përfundimtare për miratimin, monitorimin dhe rishikimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë. Të gjitha politikat për sigurimin e cilësisë së proceseve akademike hartohen nga organe kolegjiale si, Senati, Rektorati, Dekanati etj.</p>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo	<p>U_POLIS vlerëson dhe favorizon përshkallëzimin e metodikës në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në këtë kuadër përfshirja dhe aktivizimi i të gjithë aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit është një nga objektivat kryesore të IAL në këtë drejtim. U_POLIS është transparent lidhur me informacionin apo aktivitetin që duhet të realizohet lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Kjo transparencë</p>

pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	paraqitet në mbledhjet e hapura të senatit që bëhet të paktën 1 herë në vit.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<p>Në nivel institucional, U_POLIS ka disa marrëveshje bashkëpunimi. Kjo lejon që të ketë mobilitet të stafit dhe studentëve, si një element plus në shkëmbimin e eksperiencave ndërmjet palëve. Gjithashtu U_POLIS dhe FKZH konsultohen në mënyrë të vazhdueshme me aktorë të jashtëm dhe palë të treta, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit Master Shkencor Shkenca Kompjuterike.</p> <p>Aneks 24 Politika ne mbeshtetje te stafit per kerkimin shkencor.pdf</p> <p>Aneks 25 Politika Mbeshtetese dhe Marreveshje bashkepunimi i Msc.pdf</p> <p>Aneks 51 Internal Quality Assurance Strategy 2023-2027.pdf</p> <p>Aneks 54 Marreveshjet aktive për programin e studimit.pdf</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstatoi se U_POLIS operon me procedura të sigurimit të cilësisë që demonstronë transparencë dhe përgjegjësi për të gjithë aktorët e saj. I gjithë personeli akademik dhe administrativ ka një rol kyç në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm me Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë. Senati si organi më i lartë akademik ka përgjegjësinë përfundimtare për miratimin, monitorimin dhe rishikimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë. Të gjitha politikat për sigurimin e cilësisë së proceseve akademike hartohen nga organe kolegjiale si, Senati, Rektorati, Dekanati etj.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>U_POLIS përmes mbledhjeve të hapura ndërgjegjëson personelin akademik dhe administrative për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimit të cilësisë në universitet. Njësia ka mbështetje dhe autonomi të plotë nga POLIS. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, NJSBC, bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike. Rezultatet e gjeneruara nga pyetesorët paraqiten në raport vjetor që kjo njësi përpunon.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>U_POLIS publikon rezultatet e vlerësimeve, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Rezultatet e gjeneruara nga pyetesorët paraqiten në raportin vjetor që kjo njësi përpunon. Gjithashtu rezultatet pasi është vënë në dijeni rektori dhe përgjegjësi i departamentit, ato dergohen me mail të dedikuar stafit.</p> <p>Aneks 9_Rregullore Etike.pdf</p> <p>Aneks 8_Rregullore NJBSC.pdf, Neni 5, 6</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. Në fund të çdo viti, rezultatet e vlerësimit hartohen në formën e Raportit Vjetor, i cili dorëzohet në rektorat. Analiza e këtyre të dhënave përcakton rekomandimet për përmirësimin e cilësisë dhe mësimdhënies.</p> <p>Aneks 32_Raporti Vjetor NJBSC 2022-2023.pdf</p> <p>Aneks 22_Raport Vjetor kerkimi shkencor 22-23.pdf</p> <p>Aneks 48_Raporti Vjetor 2022-2023.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>U_POLIS ka një strukturë të organizative të qëndrueshme dhe efektive e drejtuar ndaj përmirësimeve të vazhdueshme, bazuar në kërkesat institucionale, ligjore dhe standartet e cilësisë. Në lidhje me programin e studimit, janë marrë masa për rishikimin dhe përmirësimin e rregullores, kurrikulës, syllabuseve etj.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe</p>	<p>NJSBC harton një plan periodik aktiviteteve, ku përfshihen takime, mbledhje, njoftime në lidhje me proceset e akreditimit, të cilat lidhen me cilësinë e programit që ata bëjnë pjesë. Njësia</p>

studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	mblidhet periodikisht dy herë në vit, për të diskutuar mbi: punën e kryer, çështje të organizimit të cilësisë, procesin e hartimit të planit institucional për sigurimin e cilësisë, procesin e monitorimit të sigurimit të cilësisë, vendosjen e indikatorëve, konkluzionet e monitorimit, rekomandimet etj. <i>Aneks 8_Rregullore NJBSC.pdf, Neni 8</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se U_POLIS ka një strukturë të organizative të qëndrueshme dhe efektive e drejtuar ndaj përmirësimeve të vazhdueshme, bazuar në kërkesat institucionale, ligjore dhe standartet e cilësisë. U_POLIS publikon rezultatet e vlerësimeve, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Shkenca Kompiuterike”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Institucioni kujdeset në përditësimin e vazhduar të programit të studimit, në përputhje me nevojat e tregut të punës, kurrikulave analoge të vendeve anëtare të BE, dhe zhvillimet më të fundit të fushës;
2. Institucioni angazhon në mësimdhënie staf akademik të kualifikuar, me eksperiencë të gjatë akademike dhe profesionale;
3. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucione vendase dhe të huaja, përmes të cilave mundëson shkëmbimin e stafit dhe studentëve, ndarjen e eksperiencave dhe zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve në përputhje me nevojat e programit të studimit;
4. Institucioni në funksion të këtij programi studimi disponon laboratorë me pajisje bashkëkohore për zhvillimin e aftësive të studentëve në përputhje me nevojat konkrete të tregut e punës;

5. Institucioni punon në mënyrë të vazhduar në kuadër të sigurimit të cilësisë, duke bashkërenduar punën e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në këtë proces;
6. Realizimi i ngarkesës është në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi;
7. Përfshirja e studentëve në qeverisje dhe vendimmarrje;
8. Angazhimi i stafit dhe studenteve në projekte ndërkombëtare;
9. Institucioni ofron program të njëjtë studimi *Master i Shkencave* në “Shkenca Kompjuterike” për studentet e diplomuar në ciklin paraardhës *Bachelor* në “Shkenca Kompjuterike”;
10. Institucioni organizon konferenca studentore që të angazhohen studentët me kërkim shkencor dhe prezantime;
11. Institucioni nxit përfshirjen e studentëve dhe institucioneve partnere në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit të ofruara, duke dëshmuar një përmirësim të vazhduar të ofertës së tij akademike;
12. Lidhje e fortë dhe ndërvepruese student –pedagog;
13. Krijimi dhe angazhimi i studentëve në klubet studentore si: “Klubi i Web-it”, “Klubi i Robotikës dhe AI”, “Klubi Sportit” dhe “Klubi i Librit dhe Artit”;

b. Pika të dobëta:

1. Institucioni nuk harton raporte analitike të mirëfillta të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit duke specifikuar qartazi përfitimet për secilin program studimi të ofruar; (*Standardi I.3, Kriteri 4*)
2. Mungesa e literaturës (hardcopy) specifike, botime të viteve të fundit për fushën e Shkencave Kompjuterike, në gjuhën shqip dhe anglisht në bibliotekën e universitetit; (*Standardi IV. 3, kriteri 1*);
3. Angazhimi në procesin e mësimdhënies në këtë program studimi, të stafit akademik me Msc, duke mos plotësuar kushtin ligjor për të patur së paku kualifikimin e ciklit pasardhës sipas parashikimit të nenit 59/6 të Ligjit nr. 80/2015 (*Standardi IV.1, kriteri 1*).

Rekomandime

1. Institucioni të hartojë raporte analitike të mirëfillta të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit duke specifikuar qartazi përfitimet për secilin program studimi të ofruar;
2. Përfshirja e detyrave të kursit/projektet në kurrikul dhe në syllabuset e lëndëve si orë në auditor (*1 ECTS = 1 -2 orë në auditor*).
3. Të realizohet shpërndarja e orëve në auditor së bashku me temat përkatëse për secilën orë referuar secilës kategori: leksion, seminar, laborator dhe detyre kursi;

4. Të përditësohen titujt e rekomanduar të literaturës në syllabus-et e lëndëve dhe në bibliotekë me botime të viteve të fundit.
5. Të nxitet përfshirja e studentëve në mobilitete.
6. Institucioni të hartojë një udhëzim për përgatitjen e relacionit **praktikës profesionale**.
7. Për realizimin e programit të studimit, IAL të angazhojë në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën gradën shkencore Dr., në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik;

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in "Computer Science"

a. Strengths and affirmations:

1. The Institution takes care to continuously update the program of study, in accordance with the needs of the labor market, the similar curricula of EU member countries and the latest developments in the field;
2. The Institution engages in teaching qualified academic staff with long academic and professional experience;
3. The Institution has cooperation agreements with national and international institutions, through which it enables the exchange of staff and students, the sharing of experiences and the development of professional practices of students in accordance with the needs of the program of study;
4. The institution in function of this program of study has laboratories with modern equipment for the development of students' skills in accordance with the concrete needs of the labor market;
5. The institution works continuously in the framework of quality assurance, coordinating the work of all internal and external stakeholders in this process;
6. The teaching load of academic staff is in accordance with the legal and by-laws in force;
7. Involvement of students in governance and decision making;
8. Engagement of staff and students in international projects;
9. The institution by offering *Master of Science* in "Computer Science" guarantee continuity for the students which are graduated in *Bachelor* "Computer Science" in POLIS University;
10. The institution organizes Student Conferences which motivate to engage students in research and presentations;
11. The institution motivates the students and partner institutions in writing and enhancing the study programs, demonstrating a continuing enhancement in academic offer;


12. Strong and interactive student-teacher relationship;
13. Creation and engagement of students in student clubs such as: “Web Club”, “Robotic and Artificial Intelligence Club”, “Sport Club” dhe “Book and Art Club”;

b. Weaknesses:

1. The institution does not prepare analytical reports on the benefits from cooperation agreements, clearly specifying the benefits for each program of study offered; [Standard I.3, Criteria IV].
2. Lack of recently years computer science’s literature in albanian and english language in university library; [Standard IV.3].
3. In the programming study, the institution has engaged academic staf with MSc. Degree, being not in accordance with law’s condition of Law no. 59/6 No. 80/2025; (*Standard IV.1, Criteria 1*)

Recommendation

1. The Institution should prepare analytical reports on the benefits from cooperation agreements, clearly specifying the benefits for each program of study offered;
2. Course assignments/projects needs to be identified in the curricula and syllabuses as hours in auditorium; (*1 ECTS = 1 -2 hours in auditorium*)
3. Specify the distribution of hours in auditorium, including their respective topic, referring each category: lecturers, seminars, laboratores, and course projects;
4. Update the recommended physical and digital literature in syllabuses with books published in latest 5 years;
5. Encourage the students’ involvement in the research activities of the Department and mobilities;
6. The institution should prepare a “*Professional Practice Guidelines*” to clearly specify how to prepare the report and presentation of professional practice;
7. To realize the study program Master of Science in "Computer Science", HEI must engage in the teaching process only academic staff at least with the scientific degree 'Doctor of Science (DR.)', in accordance with the legal requirements for the appropriate level of academic qualification;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
			Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X